



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË DIBËR

RAPORTI VJETOR

I PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

DIBËR

MBI ECURINË E PUNËS

PËR VITIN 2018

SHKURT 2019

PËRMBAJTJA E LËNDËS

I. Drejtimit dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2018

- Respektimi i të drejtave të njeriut;
- Të miturit dhe grupet vulnerabël, si të pandehur dhe viktima;
- Bashkëpunimi ndërinstitucional;
- Bashkëpunimi ndërkombëtar;
- Përdorimi i metodave speciale hetimore dhe hetimet proaktive;
- Informacion mbi zbatimin e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm;
- Informacion mbi zbatimin e Rezolutës së Kuvendit dhe planit të veprimit në zbatim të saj;
- Informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimeve të prokurorit të Përgjithshëm të nxjerrë në bazë të tyre
- Informacion statistikor mbi çështjet penale që lidhen me procesin e verifikimit të Integritetit të Personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë Funksione Publike;
- Të dhëna për temat dhe numrin e trajnimeve të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, apo të përbashkëta me policinë e shtetit;
- Problematikat e hasura.

II. Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës së prokurorisë për vitin 2018

- Volumi i punës në hetim;
- Çështje të përfaqësuara në gjykatë;
- Treguesit kryesor të punës së prokurorisë Dibër për vitin raportues;
- Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale;
- Të dhëna në lidhje me masat e sigurimit personal e pasuror;
- Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë;
- Kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale të njësive administrative në kompetencë të prokurorisë Dibër;
- Kriminaliteti sipas peshës/përhapjes së veprave penale;
- Kriminaliteti sipas strukturës së Kodit Penal (krime- kundërvajtje).

III. Treguesit statistikorë 2 vjeçar të veprave penale sipas strukturës së Kodit Penal

- Treguesit statistikorë për numrin e procedimeve të regjistruara, numrin e procedimeve të dërguara për gjykim, numrin e të pandehurve dhe personave nën hetim të regjistruar, numrin e të pandehurve dërguar për gjykim, numrin e të pandehurve të dënuar.

IV. Analiza e treguesve të efektivitetit të punës së prokurorisë Dibër për vitin 2018

- Treguesi i efektivitetit në gjykimin dhe në dënimin e të pandehurve;
- Të dhëna për gjykimet e posaçme ;
- Të dhëna mbi llojet dhe masat e dënimeve;
- Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit;
- Të dhëna për të pandehurit e mitur;
- Të dhëna për pasojat e veprave penale.

V. Të dhëna lidhur me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja

- Ekstradime (ekstradime nga jashtë, ekstradime për jashtë);
- Letërporositë (letërporositë nga jashtë, komisione rogatore dhe dorëzime të kontrolluara, letërporositë për jashtë);
- Njohjet e vendimeve penale (njohjet e vendimeve penale të huaja, njohjet e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit);
- Transferimet e procedimeve penale (transferimet e procedimeve nga jashtë, transferimet e procedimeve për jashtë);
- Transferimet e personave të dënuar (transferimet e personave të dënuar nga jashtë, transferimet e personave të dënuar për jashtë);
- Shpalljet në kërkim ndërkombëtar, heqjet nga kërkimi ndërkombëtar.

VI. Të dhëna për ngarkesën e punës për çdo prokuror dhe oficer të policisë gjyqësore

VII. Informacion mbi administrimin e prokurorisë

- zbatimi i buxhetit, marrëdhëniet me median dhe publikun, rregullsia e mbajtjes së regjistrave dhe raporteve, respektimi i disiplinës në punë dhe etikës së punonjësve etj.

VIII. Drejtimit dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit për vitin pasardhës dhe rekomandime:

KREU I

Drejtimit dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2018

Prokuroria pranë Gjykatës së shkallës së parë Dibër, si organ i ndjekjes penale, analizon në këtë raport veprimtarinë e punës të periudhës një vjeçare për vitin 2018, gjendjen e kriminalitetit në territorin ku ushtron juridiksionin dhe veprimtarinë e saj, përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe Kushtetuese si Institucion dhe të prokurorëve që e përfaqësojnë atë, arritjet, problemet dhe mangësitë e evidentuara, si dhe përcaktimin e prioritetëve dhe drejtimeve kryesore për rritjen e performancës në veprimtarinë e saj në të ardhmen.

Gjatë vitit 2018, Prokuroria e rrethit gjyqësor Dibër ka ushtruar veprimtarinë e saj në mbështetje dhe respektim të plotë të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, si dhe ato që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare dypalëshe dhe shumëpalëshe, të ratifikuara me ligj nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ushtrimi i kësaj veprimtarie kushtetuese dhe ligjore, ashtu siç edhe do të analizohet në vijim të këtij raporti, është kryer bazuar në një angazhim maksimal të të gjithë stafit të kësaj prokurorie, duke ndjekur dhe respektuar njëkohësisht urdhrat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë.

Në fokus të veprimtarisë të punës së Prokurorisë së rrethit gjyqësor Dibër, ka qenë lufta dhe ndëshkimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar, si fenomene të përhapura që kanë qenë dhe janë pengesë në zhvillimin e vendit dhe të shoqërisë në përgjithësi.

Kështu në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Dibër për vitin 2018, është referuar dhe regjistruar 1 rast korrupsioni sipas nenit 244 të Kodit Penal, "*Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", i cili është dërguar për gjykim. Gjithashtu janë referuar nga policia e shtetit dhe nga subjekte të tjera, 17 raste për veprën penale të "*Shpërdorimit të detyrës*" parashikuar nga neni 248 të Kodit Penal, ku një rast është referuar nga KLSH. Gjithashtu janë regjistruar 3 procedime penale për veprën penale të "*Refuzimi për deklaram, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publik, ose çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram*" parashikuar nga neni 257/a/1 i Kodit Penal mbi bazën e kallëzimit të ILDKPI-së, ku një çështje është dërguar për gjykim. Gjithashtu është regjistruar edhe një procedim penal për veprën penale të "*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*" parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal, i referuar nga KLSH.

Për sa i përket grup veprave penale në lidhje me krimin e organizuar dhe krimet e rënda, janë regjistruar për vitin 2018, gjithsej 5 procedime penale si dhe janë hetuar edhe 8 procedime të mbartur nga vitet e tjera për veprën penale të "*Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve*" parashikuar nga neni 283 të Kodit Penal. Nga këto 13 procedime penale është kërkuar dërgimi për gjykim për 8 procedime penale, është kërkuar pushimi për 2 procedime penale, është vendosur pezullimi për 1 procedim penal dhe për 1 procedim vazhdon hetimi.

Për sa i përket grup veprave të pastrimit të parave, janë regjistruar 8 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 287 të Kodit Penal, prej të cilëve në 2 raste është vendosur pezullimi dhe për 6 prej tyre vazhdojnë hetimet, pasi ato shtrihen në territorin e vendit dhe jashtë.

1.1 RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT

Prokuroria e rrethit gjyqësor Dibër, ka pasur si përparësi në veprimtarinë e saj respektimin e të drejtave të njeriut, mbrojtjen e këtyre të drejtave në rast të cënimit të tyre, si mbrojtjen e të drejtës mbi pronën private dhe publike nga veprimet e paligjshme etj, duke bashkëpunuar edhe me institucionet e tjera vendore dhe qendrore me qëllim hetimin e veprave penale në këtë fushë, në kohë sa më të shpejtë dhe parandalimin e pasojave kriminale.

Respektimi i të drejtave të ligjshme të qytetarëve dhe mbrojtja e lirive themelore të tyre duke garantuar në çdo rast procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, është detyrim kushtetues i prokurorisë.

Të drejtat janë respektuar gjatë hetimeve paraprake dhe në mënyrë të veçantë në zbatimin e kushteve dhe kriterëve ligjore në kërkimet për caktimin e masave të sigurimit dhe të dënimit, duke u nisur nga parimi i ligjshmërisë dhe proporcionalitetit.

1.2 TË MITURIT DHE GRUPET VULNERABËL, SI TË PANDEHUR DHE VIKTIMA

Qëllimi i Prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër përgjatë vitit 2018, me hyrjen në fuqi të ligjit nr.37/2017 datë 30.03.2017 “*Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur*” ka qenë promovimi dhe mbrojtja efektive e të drejtave për të miturit në konflikt me ligjin, viktimat, dëshmitar të veprave penale dhe të miturit që nuk kanë mbushur moshën për përgjegjësi penale.

Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër gjatë vitit 2018 ka regjistruar gjithsej 31 procedime penale me 43 të pandehur, 28 nga të cilët të mitur (25 meshkuj dhe 3 femra), 3 të grup moshës 14-16 vjeç dhe 25 të grup moshës 16-18 vjeç, në rastet e tjera i mituri ka qenë viktimë ose dëshmitar.

Të miturit në konflikt me ligjin janë hetuar në gjendje të lirë dhe në dy raste përkatësisht për nenin 278/1 dhe 290/3 të Kodit Penal është caktuar ndaj tyre masa e sigurimit “*Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” parashikuar nga neni 234 i Kodit Penal, në zbatim të neneve 81-87 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Prokurorët pranë Prokurorisë Dibër, janë angazhuar në sesione trajnuese me qëllim rritjen profesionale, kryesisht në lidhje me ndryshimet që ka pësuar legjislacioni pena procedural dhe material si dhe në fushën e drejtësisë penale për të mitur

Gjithashtu në kuadër të vendimit nr.255 datë 19.12.2018 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vlen të theksohet se Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër në vazhdimësi është angazhuar në garantimin e përmbushjes së të drejtave për personat me aftësi të kufizuara viktimë apo person nën hetim duke garantuar prezencën e mbrojtësit dhe të psikologut, zbatimin korrekt të masave të sigurimit për të pandehurit me probleme të shëndetit mendor duke u angazhuar çdo një vit në verifikimin e kushteve të masave mjekësore të caktuara më herët.

1.3 BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

1.3.1 Raporti me Prokurorin e Përgjithshëm të Republikës

Gjatë vitit 2018, Prokurori i Përgjithshëm, ka nxjerrë disa urdhra dhe udhëzime, zbatimimi i të cilëve ka qenë në fokus të prokurorëve me qëllim mbarëvajtjen e punës së prokurorisë dhe zbatimin korrekt të ligjit penal procedural. Këto urdhra dhe udhëzime janë punuar edhe me oficerë të policisë gjyqësore.

1.3.2 Raporti me Drejtoritë përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme

Nga ana e Prokurorisë së rrethit gjyqësor Dibër, për vitin 2018, bashkëpunimi me Drejtoritë përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme, ka qenë korrekt duke u angazhuar maksimalisht në përmbushje e detyrave që parashikon ligji. Komunikimet me të shpeshta kanë qenë me Drejtorinë e inspeksionit, ndihmës për subjektet e posaçme, mbrojtjes së dëshmitarëve, burimeve njerëzore, studimeve dhe projekteve për verifikimin e subjekteve të ndryshëm dhe përgatitjen e informacioneve për problematika të caktuara si dhe Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, për rastet e ekstradimeve, njohjes së vendimeve penale të huaja dhe ekzekutimit të letër-porosive të ardhura nga jashtë shtetit. Kështu ka pasur 23 raste të ekzekutimit të letër-porosive nga jashtë shtetit, me objekte të ndryshme, si kryerjen e veprimeve hetimore të kërkuara, njoftimin e shtetasve të ndryshëm për vendimet e dhëna ndaj tyre nga gjykatat e vendeve të tjera, etj.

1.3.3 Raporti me Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër dhe Komisaritet e Policisë Dibër dhe Bulqizë

Bashkëpunimi me këto Institucione ka qenë shumë i ngushtë, për një qëllim të përbashkët, parandalimin e krimeve, evidentimin dhe dokumentimin e tyre, vënien e autorëve para përgjegjësisë penale dhe ndëshkimin e tyre sipas ligjit me qëllim, parandalimin e përgjithshëm dhe të posaçëm të veprave penale në të ardhmen.

Numri më i madh i procedimeve penale të regjistruara, rrjedh nga referimi e strukturave të policisë së shtetit, gjithsej **1021** referime të veprave penale nga **899** të referuara vitin e kaluar. Një kujdes i veçantë i është treguar dhënies së udhëzimeve dhe detyrave për oficerët e

policisë gjyqësore ne strukturat e policisë së shtetit që janë deleguar për hetimin e çështjeve penale te referuara nga ana e tyre.

Për të përmirësuar punën, nga ana jonë janë ndërmarrë masa konkrete duke u angazhuar në trajnimin e punonjësve të policisë së komisariateve Dibër, Bulqizë dhe Mat si dhe punonjësve të policisë së Drejtorisë Vendore Dibër. Kështu më datë 16.02.2018, nën kujdesin e Prokurorisë së Përgjithshme është zhvilluar trajnimi me temë “*Ndryshimet ligjore të ndërmarra për reformën në drejtësi, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penal dhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur*”

Shkolla e Magjistraturës nuk ka të parashikuar në programin e saj sesione trajnuese për shërbimet e policisë gjyqësore. Ndryshimi thelbësor që ka pësuar kuadri ligjor në fushën e të drejtës penale kërkon domosdoshmërisht edhe trajnimin e policisë gjyqësore si një nga subjektet e Kodit të Procedurës Penale dhe hallkë shumë e rëndësishme e hetimit;

1.3.4 Raporti me Gjykatën e rrethit gjyqësor Dibër:

Bashkëpunimi me Gjykatën, ka qenë korrekt dhe i bazuar me pavarësinë e secilit organ. Prokurorët kane qenë korrekt në paraqitjen e tyre në seancat gjyqësore si për sa i përket etikës ashtu edhe përfaqësimit të çështjeve. Nuk ka pasur raste të evidentuara nga ndonjë gjyqtar në lidhje me sjelljen, etikën, paraqitjen apo përfaqësimin e akuzës nga ana e prokurorëve në Gjykatë. Është koordinuar puna në rastet e trajnimit të përbashkët të prokurorëve dhe gjyqtarëve.

1.3.5 Raporti me Institucionet e tjera:

Një bashkëpunim reciprok ka pasur edhe me institucionet e tjera lokale dhe qendrore, si me Zyrën Përmbarimore, Zyrën e Shërbimit të Provës, I EVP Burrel etj, në nxjerrjen në kohë të urdhrave të ekzekutimit të vendimeve penale nga ana e prokurorit, në mbikqyerjen në vazhdimësi të ekzekutimit dhe zbatimit të dënimeve penale, kohën e provës etj. Vetëm për vitin 2018, janë nxjerrë ne zbatim të vendimeve gjyqësore, 354 urdhra ekzekutimi nga ana e prokurorit, lidhur me dënimet e burgim, me gjobë, dënimet alternative, provat materiale dhe shpenzimet procedurale (138 urdhra më shumë se në vitin 2017).

Institucionet e tjera kanë qenë bashkëpunuese, janë kthyer në kohë përgjigjet e kërkesave të organit të prokurorisë në funksion të hetimit të procedimeve penale etj. Janë organizuar takime me faktorët e tjerë për sensibilizimin e opinionit për të dhënë ndihmën e duhur në parandalimin e veprave penale në marrëdhëniet familjare, në ndikimin pozitiv të grupeve vulnerabël, sidomos të të miturve për të mos kryer vepra penale, etj.

1.4 BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Bashkëpunimi me autoritetet gjyqësore ndërkombëtare, është arritur nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme. Siç u theksua më sipër, prokurorët kanë qene korrekt dhe të shpejtë në ekzekutimin e letër-kërkesave të ndryshme të autoriteteve të huaja gjyqësore, si në njoftimin e dëshmitarëve, njoftimin e të pandehurve, njoftimin e vendimeve penale të gjykatave të huaja, etj.

1.5 PËRDORIMI I METODAVE SPECIALE HETIMORE DHE HETIMET PROAKTIVE

Gjatë vitit 2018, në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Dibër, ka marrë masa për realizimin e përgjimeve të telekomunikimeve për të gjitha çështjet ku plotësoheshin kushte dhe kriteret ligjore dhe në disa prej tyre ka pasur rezultate të mira në interes të hetimit.

Në të ardhmen mendojmë se do të intensifikohet puna në drejtim të përdorimit të këtyre metodave speciale të hetimit, duke qenë se krimi i organizuar dhe krimi në përgjithësi po avancojnë dhe po bëhet sa më konspirativ.

1.6 INFORMACION MBI ZBATIMIN E UDHËZIMEVE TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

Në zbatim të nenit 42 germa “g”, të ligjit nr.97/2016 “*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*”, janë marrë masat për zbatimin efektiv të Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm. Më poshtë po pasqyroj masat konkrete që janë marrë për secilin prej udhëzimeve:

1. Udhëzimi i Përgjithshëm **nr.1 datë 20.02.2018** “*Për krijimin e seksioneve të posaçme*” në prokurorinë për krime të rënda dhe në Prokuroritë e rretheve gjyqësor Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Fier, Shkodër, Llezhe, Korçë e Gjirokastrë për hetimin e veprave penale sipas kompetencave të përcaktuara në atë udhëzim, i nxjerrë në kuadrin e zbatimit të Marrëveshjes nr.413 prot dhe nr.937 prot datë 02.02.2018 ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm, si dhe në funksion të planit të veprimit, për luftën kundër krimit të organizuar;

Në zbatim pikës “4” të kreut II, “*Kompetencat Lëndore dhe Tokësore*” të këtij udhëzimi nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, ku për shkak të numrit të pamjaftueshëm të prokurorëve është e pamundur ngritja e seksioneve sipas ligjit, në rastet kur janë evidentuar vepra penale nga ato të përcaktuara në pikën “2” të të njëjtit Kre, janë përgatitur informacionet përkatëse, të cilat i janë përcjellë Drejtorisë së Subjekteve të Posaçme, Mbrojtjes së Dëshmitarëve, Studimeve, Projekteve, Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, Pranë Prokurorisë së Përgjithshme, nëpërmjet e-mail-it.

2. Udhëzimi i Përgjithshëm nr.2 datë 18.06.2018 *“Për koordinimin e punës në çështjet e ekstradimit për jashtë shtetit”*. Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër menjëherë pas marrjes së kërkesës për informacion nga prokuroritë e rretheve ose nga Prokuroria e Përgjithshme është angazhuar maksimalisht në dhënien e informacionit brenda një afati sa më të shkurtër nëpërmjet e-mail-it apo me shkresë zyrtare. Gjithashtu në të gjitha kërkesat për ekstradim është kërkuar dhe administruar informacioni nga prokuroritë e rretheve.
3. Udhëzimi i Përgjithshëm **nr.3 datë 26.10.2018** *“Për vlerësimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”*;
 - Në zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr.3 datë 26.10.2016 si dhe në zbatim të nenit 42 germa “g”, 46 dhe 52 pika “1” të ligjit nr.97/2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”* nga ana ime është nxjerrë udhëzimi nr.01/2 datë 04.01.2019 *“Për pajisjen me certifikatë sigurie dhe administrimi informacionit të klasifikuar sekret shtetëror”*. Punonjësit që duhet të pajisen me “Certifikatë sigurie”, bashkë me udhëzimin u janë vënë në dispozicion edhe dokumentacioni i nevojshëm për t’u plotësuar si: Deklaratën për ruajtjen e “Sekretit shtetëror”, Deklaratën përmes së cilës kërkuesi jep pëlqimin që ndaj tij të mblidhen të dhëna dhe të bëhen verifikime dhe Pyetësorin personal të sigurisë të hartuara nga Drejtoria e Sigurimit dhe të informacionit të Klasifikuar;
 - Qëllimi i Udhëzimit nr.01/2 datë 04.01.2019 është lehtësimin e zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr.3 datë 26.10.2016, në përputhje me organikën e Prokurorisë Dibër;
 - Vlen të theksohet si arritje pozitive e Udhëzimit të Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr.3 datë 26.10.2016, vënia në lëvizje e procesit për pajisjen me certifikatë sigurie të punonjësve, të cilat për shkak të pozicionit të punës mund dhe duhet të njihen me informacionit të klasifikuar si "sekret shtetëror";
 - Me qëllim informimin e prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe të punonjësve të tjerë si dhe diskutimin e problematikave në lidhje me dy udhëzimet e sipërcituara më datë 25.01.2019 është thirrur mbledhja e prokurorëve. Objekt diskutimi dhe trajtimi në mbledhje kanë qenë edhe udhëzimet nr.4, nr.5 dhe nr.6 të vitit 2018 të Prokurorit të Përgjithshëm
4. Udhëzim i Përgjithshëm **nr.4 datë 26.10.2018** *“Për përgjimet”*;
 - Në zbatim të udhëzimit të mësipërm dhe legjislacionit në fuqi me qëllim garantimin e parashikimeve ligjore gjatë aplikimit të “Përgjimit” si mjet për kërkimin e provës, nga ana ime është thirrur mbledhja e prokurorëve, ku janë diskutuar detyrimet që rrjedhin nga ky udhëzim si dhe problematikat që hasen në praktikë mbi përmbushjen e tyre.
5. Udhëzimi i Përgjithshëm **nr.5 datë 26.10.2018** *“Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale”*;

Në zbatim të udhëzimit të mësipërm dhe legjislacionit në fuqi me qëllim garantimin e të drejtave të viktimës apo dëshmitarit si dhe garantimi i asistencës ndaj, nga ana ime është thirrur mbledhja e prokurorëve, ku janë diskutuar detyrimet që rrjedhin nga ky udhëzim si dhe problematikat që hasen në praktikë mbi përmbushjen e tyre.

Ashtu sikurse është sqaruar edhe më herët në raportin për të miturit në konflikt me ligjin, të miturit viktimë apo dëshmitar Prokuroria Dibër ka marrë masat e nevojshme për garantimin e të drejtave që ligji parashikon për të miturit pavarësisht statusit. Gjithsesi në praktikë janë hasur vështirësi që kanë të bëjnë me mungesën e psikologëve të miratuar dhe që ushtrojnë funksionin në territorin e Prokurorisë Dibër apo mungesa e qendrave pritëse për viktimat e veprave penale.

Prokurorët pranë Prokurorisë Dibër, janë angazhuar në sesione trajnuese me qëllim rritjen profesionale, kryesisht në lidhje me ndryshimet që ka pësuar legjislacioni pena procedural dhe material si dhe në fushën e drejtësisë penale për të mitur

6. Udhëzim i përgjithshëm **nr.6 datë 26.10.2018** “*Për hetimin pasuror, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale*”;

- Në zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr.6 datë 26.10.2016 si dhe në zbatim të nenit 42 germa “g”, 46 dhe 52 pika “1” të ligjit nr.97/2016 “*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*” nga ana ime është nxjerrë udhëzimi nr.01/1 datë 04.01.2019 “*Për zbatimin e ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe Krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar*”;
- Qëllimi i Udhëzimi nr.01/1 datë 04.01.2019 është lehtësimin e zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr.6 datë 26.10.2016, duke individualizuar veprat penale kompetencë e prokurorive të rretheve si dhe duke përcaktuar rregulla të detajuara për mënyrën se si do të procedohet me dosjet e përfunduara si dhe me dosjet në hetim apo që do të regjistrohen. Gjithashtu është ngarkuar zyra e regjistrit për krijimin dhe mbajtjen e një regjistri të veçantë për rastet e njoftimit të Prokurorisë për Krime të Rënda, në lidhje me nisjen e hetimit pasuror si dhe është ngarkuar Zyra e Protokollit, për dokumentimin në regjister të protokollit të informacioneve dhe njoftimeve që do t’i përcillen Prokurorisë për Krime të Rënda;
- Nga ana e zyrës së regjistrit janë evidentuar **117 çështjet penale** të përfunduara, të cilat po i përcillen gradualisht Prokurorisë për Krime të Rënda, kjo për shkak të volumit të tyre, e cila kërkon angazhimin e burimeve njerëzore të cilët njëkohësisht janë të angazhuar edhe me përmbushjen e detyrave të përditshme dhe numri i tyre nuk është i mjaftueshëm për përmbushjen në kohë të detyrimeve që rrjedhin nga udhëzimi;

- Si rezultat i Udhëzimit të Përgjithshëm nr.6 datë 26.10.2016 të Prokurorit të Përgjithshëm ka nisur një punë intensive për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga neni 3 i Ligjit nr.10192/2009 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i ndryshuar me ligjin nr.70/2017 datë 27.04.2017;
- Në lidhje me çështjet në hetim apo për çështjet të cilat do të referohen apo regjistrohen në vazhdim në mbledhjen përkatëse, përveç njohjes me udhëzimet përkatëse është kërkuar nga prokurorët nisja e verifikimeve pasurore sipas legjislacionit në fuqi.

1.7 INFORMACION MBI ZBATIMIN E REZOLUTËS SË KUVENDIT DHE PLANIT TË VEPRIMIT NË ZBATIM TË SAJ

1. Rritjen e numrit të hetimeve në tërësi dhe në veçanti hetimeve proaktive kundër krimit të organizuar, korrupsionit në nivel zyrtarësh të lartë dhe të mesëm, funksionarëve të sistemit të drejtësisë, të zgjedhurve në nivel qendror dhe vendor:

Në Kreun II të këtij raporti janë pasqyruar në mënyrë të detajuar treguesit e kriminalitetit për vitin 2018 si dhe në Kreun III të raportit është bërë krahasimi ndërmjet dy viteve. Kështu rezulton se ka pasur një rritje të ndjeshme prej 12 % të materialeve të referuar në Prokurorinë Dibër për vitin 2018 në raport me vitin 2017;

Nuk rezulton të ketë pasur një rritje të hetimeve proaktive, kjo sikurse është shpjeguar edhe përgjatë këtij raporti vjen edhe si pasojë e mbingarkesës së prokurorëve apo mungesës së specializimit të tyre apo oficerëve të policisë gjyqësore. Theksohet se ndërkohë që kemi një rritje në tërësi të numrit të materialeve të referuara, vendimeve penale të ekzekutuara, masave të sigurimit, përfaqësimit në gjyq, kërkesave për informacion, Prokuroria Dibër ka një numër më të ulët prokurorësh efektivë (vetëm tre).

2. Rritjen e numrit të hetimeve proaktive për veprat penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, trafikimi të narkotikëve dhe kultivimit të bimëve narkotike:

Në lidhje me veprat penale të parashikuara nga nenet 283 dhe 284 i Kodit Penal rezulton se ka një rënje të dukshme të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepra penale.

	2016	2017	2018
Neni 238	11	19	5
Neni 284	28	8	1

Ndërkohë që ka një rritje të numrit të të pandehurve të dërguar për gjykim për nenin 283 të Kodit Penal nga 9 në vitin 2017 në 14 në vitin 2018. Gjithashtu rezulton se ka një rënje të numrit të çështjeve të pushuara, nga 7 çështje të pushuara në vitin 2017 me 3 çështje të pushuara në vitin 2018.

3. Rritjen e numrit të hetimeve pasurore për identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive, mjeteve dhe produkteve të veprave penale me origjinë krimin e organizuar, sipas ligjit antimafia:

Në rastet ku është vlerësuar e nevojshme sipas parashikimeve të nenit 3 të Ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “*Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe Krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, i ndryshuar” kur është vlerësuar se ekzistojë indicie për përfitim pasuror të paligjshëm është proceduar edhe me hetimin pasur, por pa mundur të evidentohen pasuri, produkt i veprës penale.

4. Garantimin e ndihmës në procesin e rivlerësimit kalimtar të prokurorëve, duke bashkëpunuar ngushtësisht me organet e reja që priten të krijohen, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, në procesin e vlerësimit profesional dhe hetimin disiplinor të prokurorëve;

Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër është angazhuar maksimalisht që informacioni i kërkuar në kuadër të vlerësimit kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve të verifikohet dhe të përcillet brenda një afati sa më të shkurtër. Gjithashtu janë marrë masë që në rastet kur ka rezultuar, informacionit t’i bashkëlidhen edhe kopje të njehsuara me origjinalin të fashikujve të mosfillimeve apo procedimeve përkatëse.

5. Forcimin e bashkëpunimit mes Prokurorisë dhe shërbimeve të Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit, si dhe agjencive të tjera ligjzbatuese, me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe përdorimin efektiv të metodave speciale të hetimit për dokumentimin e veprave penale kundër korrupsionit dhe krimeve të rënda.

Bashkëpunimi me këto Institucione ka qenë shumë i ngushtë, për një qëllim të përbashkët, parandalimin e krimeve, evidentimin dhe dokumentimin e tyre, vënien e autorëve para përgjegjësisë penale dhe ndëshkimin e tyre sipas ligjit me qëllim, parandalimin e përgjithshëm dhe të posaçëm të veprave penale në të ardhmen.

Gjatë vitit 2018, në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Dibër, ka marrë masa për realizimin e përgjimeve të telekomunikimeve për të gjitha çështjet ku plotësoheshin kushte dhe kriteret ligjore dhe në disa prej tyre ka pasur rezultate të mira në interes të hetimit.

6. Forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar me agjencitë e huaja ligjzbatuese, me qëllim luftën ndaj krimin të organizuar dhe veprave penale që lidhen me pastrimin e parave; si dhe marrjen e masave për adresimin e problematikave që konstatohen nga Progres-raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë dhe Raporti i Departamentit të Shtetit të SHBA -ve, lidhur me problematikat e krimin të organizuar në Shqipëri.

Në rastet kur ka lindur e nevojshme kryerja e verifikimeve për persona të caktuar, nga ana jonë është kërkuar informacion Zyrës së Interpolit në Tiranë në lidhje me faktin nëse ka të dhëna për aktivitetin kriminal, apo nëse rezultojnë të dënuar për ndonjë veprë penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Kur rezulton se personi për të cilin është kërkuar informacioni është dënuar apo ka qenë i dyshuar për kryerjen e ndonjë veprë penale, nga ana jonë mbështetur në nenin 509 të K.Pr.Penale është proceduar me kërkesa për ndihmë juridike, letërpororsi, drejtuar autoriteteve të huaja të drejtësisë.

7. Forcim të bashkëpunimit me partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë për parandalimin e krimeve kompjuterike që përdoren për pastrimin e të ardhurave nga aktivitete kriminale, si dhe ato për qëllime të financimit të terrorizmit:

Kërkesat për ndihmë juridike drejtuar autoriteteve të huaja të drejtësisë kanë qenë jo të pakta dhe përgjatë vitit 2018 është konstatuar një rritje e angazhimit nga ana e këtyre autoriteteve në ekzekutimin e letërporosive. Këtu vlen të përmendet angazhimi i autoriteteve maqedonase dhe greke të drejtësisë, ku para vitit 2018 përgjigjet e ardhura nga ana e këtyre autoriteteve kanë qenë sporadike ose kanë munguar tërësisht, por gjatë vitit 2018 ka pasur një angazhim serioz nga ana e këtyre autoriteteve në ekzekutimin e letërporosive dhe brenda një afati relativisht të shkurtër.

8. Ashpërsimin e politikës penale për masat e sigurisë dhe të dënimit kundër: krimit të organizuar, korrupsionit, dhunës në familje, krimeve kundër jetës, pastrimit të parave, krimit ekonomik dhe financiar, armëmbajtjes pa leje, krimit që lidhet me procesin zgjedhor, personave përsëritës në krim, krimit mjedisor:

	2017		2018	
	nr. I proc. Dërg gjyq	Te pandehur	nr. I proc. Dërg gjyq	Te pandehur
Krimi I Organizuar neni 283	8	9	8	14
Korrupsioni neni 244, 248, 257/a	9	9	5	9
Dhuna në familje neni 130/a	23	35	24	30
Krimet kundër jetës nenet 76-85	1	1	3	4
Pastrimi I parave neni 287	-	-	-	-
Krimi ekonomik dhe financiar Kreu III Të Kodit Penal	143	150	84	93
Armëmbajtje pa leje	-	--	-	-
Krimi në procesin zgjedhor	-	-	-	-
Krimi Mjedisor	-	-	-	-

Sikurse shihet nga tabela e mësipërme rezulton se numri i çështje të dërguara për gjykim për grup –veprat të cilat përmenden në pikën 8 të rezolutës së kuvendit rezulton se kemi një numër thuajse të barabartë të çështjeve dhe të pandehurve. Rezulton se kemi një rrënjë të dukshme të çështjeve të dërguara për gjykim në fushën e krimit ekonomik dhe financiar, por kjo lidhet ngushtësisht me rënien e materialeve të referuara nga ana e Institutit të sigurimeve Shoqërore Dibër ku në vitin 2017 janë dërguar për gjykim 38 çështje për nenin 145 të Kodit penal, ndërsa në vitin 2018 vetëm 5 çështje të tilla. Gjithashtu kemi një rënie të çështjeve të dërguara për gjykim për nenin 137 të Kodit Penal nga 26 në vitin 2017 në 12 në vitin 2018.

Nga ana e Prokurorisë Dibër në çdo rast kur është konstatuar se i pandehuri është recidivist janë marrë masa për ashpërsimin e politikës penale të ndjekur për rastin konkret si dhe në asnjë rast kur personi ka rezultuar recidivist nuk janë aplikuar alternativat e dënimit me burgim.

9. Të ndjekë një politikë penale më të butë ndaj të miturve, grave, personave me aftësi të kufizuara që procedohen penalisht, personave që akuzohen për kryerjen e veprave penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore, si dhe zhvillimin e hetimeve të shpejta, me qëllim shkurtimin e kohës së hetimit:

Në lidhje me Drejtësinë Penale për të Mitur janë marrë masa për zbatimin e parashikimeve që janë në fuqi prej datës 01.01.2018 ku në raste e parashikuara me ligj është zbatuar masa alternative e shmangies nga dënimi kryesisht për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Gjithashtu janë zbatuar edhe parashikimet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur edhe në raport me llojin e masave të sigurimit që janë aplikuar për të miturin në konflikt me ligjin.

Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër në vazhdimësi është angazhuar në garantimin e përmbushjes së të drejtave për personat me aftësi të kufizuara viktimë apo person nën hetim duke garantuar prezencën e mbrojtësit dhe të psikologut, zbatimin korrekt të masave të sigurimit për të pandehurit me probleme të shëndetit mendor duke u angazhuar çdo një vit në verifikimin e kushteve të masave mjekësore të caktuara më herët.

Në rastet e veprave penale të lehta, siç janë kundërvajtjet penale, janë marrë masa për përfundimin e hetimeve brenda afatit 3 mujor dhe është aplikuar gjykimi i posaçëm “*Urdhri penal*” në 128 raste.

10. Të ndjekë në vazhdimësi rastet që referohen në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*”, me qëllim sigurimin e pastërtisë së figurës së punonjësve publikë:

Gjatë vitit 2018 Drejtoria e Marrëdhënive Juridiksionale me Jashtë, Sektori i Verifikimit të Integritetit pranë Prokurorisë së Përgjithshme na ka përcjellë 3 materiale në ngarkim të nënpunësve publikë në zbatim të ligjit nr.138/2015 “*Për garantimin e integritetit të*

personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe vendimit 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, pas gjetjeve nga verifikimet paraprake. Në dy raste është përfunduar hetimi dhe çështjet janë dërguar për gjykim dhe personat janë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë. Ndërsa për rastin tjetër vazhdon hetimi.

11. Të thellojë bashkëpunimin me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme, Kontrollin e Lartë të Shtetit, ILDKPKI-në, me qëllim orientimin e një vizioni të përbashkët në politikën shtetërore që duhet të ndiqet në luftën kundër kriminalitetit në përgjithësi, korrupsionit e krimit të organizuar në veçanti:

Gjatë vitit 2018 Prokuroria e rrethit gjyqësor Dibër ka regjistruar 1 rast të *“Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”* parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal, i cili është dërguar për gjykim.

Ndërkohë janë referuar nga policia e shtetit dhe nga subjekte të tjera, 16 raste për veprën penale të *“Shpërdorimit të detyrës”* parashikuar nga neni 248 të Kodit Penal dhe një rast është referuar nga KLSH.

Gjithashtu janë regjistruar 3 procedime penale për veprën penale të *“Refuzimi për deklaram, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publik, ose ço personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram”* parashikuar nga neni 257/a/1 i Kodit Penal mbi bazën e kallëzimit të ILDKPI-së, ku një çështje është dërguar për gjykim.

Gjithashtu është regjistruar edhe një procedim penal për veprën penale të *“Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”* parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal, i referuar nga KLSH.

12. Përdorimin e instituteve procedurale, si urdhri penal, marrëveshja e fajësisë, gjykimi i drejtpërdrejtë në mënyrë efektive, për t’i shërbyer shpejtësisë së procesit dhe qëllimit të ligjit penal:

Sikurse është pasqyruar edhe më sipër nga institutet e reja të gjykimit të posaçëm të cilat u parashikuan si të tilla me ligjin nr.35 datë 30.03.2017 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i procedurës penale i republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”* një zbatim më të gjerë ka gjetur *“Urdhri penal”*, ku për vitin 2018 ky lloj gjykimi është aplikuar për 128 raste.

	Urdhra Penal	Marrëveshje fajësie	Gjykim i drejtpërdrejt
2017	32	12	1
2018	128	16	4

13. Të vazhdojë të japë kontributin e tij gjithëpërfshirës në drejtim të Reformës në Drejtësi, për reformimin e kuadrit ligjor, si në aspektin material dhe atë procedural, me qëllim përmbushjen e objektivave në këtë fushë.

Sikurse u theksua edhe më sipër Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër është angazhuar maksimalisht në këtë proces duke organizuar punën dhe burimet e saj njerëzore në mënyrë sa më efektive në funksion të këtij procesi.

1.8 INFORMACION MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE DHE UDHËZIMEVE TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM TË NXJERRË NË BAZË TË TYRE;

Në kuadër të VKM-së Nr. 203, datë 11.4.2018 “*Për miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2018*” Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër është angazhuar në zbatimin e rekomandimeve prioritare, të cilat rezultojnë të jenë fokusuar në 5 aspekte kryesore të punës së organit të akuzës.

Më poshtë po pasqyrojmë në mënyrë të përmbledhur masat specifike të marra për zbatimin e rekomandimeve (*të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë e Prokurorive të Rretheve*), për çdo pikë të secilës prej pesë fushave ku shtrihen këto rekomandime.

I. Me qëllim forcimin dhe garantimin e pavarësisë së brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale:

1.1

1.2

1.3 Marrjen e masave për respektimin e standardeve etike dhe profesionale në funksion të forcimit të integritetit të prokurorëve;

Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër, ka punuar me profesionalizëm, përkushtim e korrektësi ligjore për të përmbushur me sukses detyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, përfaqësimit e akuzës në gjyq, mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve penale dhe detyra të tjera që ligji i ngarkon asaj. Nga ana e prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore janë respektuar rregullat e etikës të parashikuara në rregulloret përkatëse. Në lidhje me problematikat e ndryshme janë marrë masa për vënien në dijeni të Prokurorit të Përgjithshëm nëpërmjet raporteve tre mujore të cilat përcillen në mbështetje të nenit 42 germa “I”, të ligjit nr.97/2016 “*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*”;

1.4 Marrjen e masave për rritjen profesionale, me qëllim njohjen dhe zbatimin e drejtë të ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale, si dhe për specializimin e prokurorëve në

funkcion të njohjes dhe zbatimit të legjislacionit penal për të miturit, të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur;

Prokurorët pranë Prokurorisë së rrethit gjyqësor Dibër me qëllim rritjen e tyre profesionale si dhe për një njohje dhe zbatim sa më efikas të ndryshimeve ka pësuar Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë dhe standardeve të reja të vendosura me hyrjen në fuqi të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur janë angazhuar në sesione trajnuese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, Prokuroria e Përgjithshme etj. Këto trajnime janë pasqyruar me tema konkrete në pikën 10, të Kreut I të këtij raporti statistikor.

- 1.5** Marrjen e masave për forcimin e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të rasteve të hetimeve, të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë.

Mbetet i ulët numri i rasteve të hetimeve të filluara kryesisht nga ana e prokurorisë, kjo edhe për shkak të ngarkesës që prokurorët pranë Prokurorisë së rrethit Gjyqësor Dibër kanë aktualisht. Ky fakt dikton nevojën e rritjes së numrit të prokurorëve në Prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër, element i cili do të sillte uljen e ngarkesë dhe do të reflektonte në rritjen e cilësisë dhe shpejtësisë së hetimit si dhe në rritjen e rasteve të hetimeve të nisura kryesisht.

- 1.6**

II. Me qëllim forcimin e luftës kundër korrupsionit:

- 2.1** Rritje të hetimeve proaktive dhe teknikave speciale të hetimit;

Gjatë vitit 2017 në Prokurorinë Dibër janë evidentuar 2 raste të përdorimit të teknikave të posaçme të hetimit sipas nenit 294/a K.Pr.Penale, veprimet simuluese. Kryerja e këtyre lloj veprimesh është kërkuar nga strukturat e SHÇBA. Ndërkohë që gjatë vitit 2018 nuk ka pasur raste të zhvillimit të hetimeve Proaktive dhe zbatimit të teknikave special të hetimit.

- 2.2** Kryerja e hetimeve sistematike pasurore dhe rritje e numrit të asetëve të sekuestruara që prej fazës fillestare të hetimit dhe konfiskimin e tyre në përfundim;

Në rastet ku është vlerësuar e nevojshme sipas parashikimeve të nenit 3 të Ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “*Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe Krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, i ndryshuar” kur është vlerësuar se ekzistojë indicie për përfitim pasuror të paligjshëm është proceduar edhe me hetimin pasur, por pa mundur të evidentohen pasuri, produkt i veprës penale.

2.3 Hetime të shpejta dhe bashkëpunim me agjencitë ligjzbatuese;

Nisur nga të dhënat statistikore rezulton se përgjatë vitit 2018 nga ana e prokurorit është vendosur zgjatja e afateve të hetimit vetëm për 21 çështje me 28 të pandehur, dy prej të cilëve të arrestuar. Kjo e dhënë, referuar numrit prej 858 çështjesh të hetuara përgjatë vitit 2018 nga Prokuroria pranë Gjykatës së shkallës së parë Dibër, tregon se **vetëm për 2.4% të çështjeve** është proceduar me zgjatje të afateve të hetimit, tregues i rëndësishëm për hetime të shpejta dhe efektive.

2.4 Bashkëpunimi me agjencitë ligjzbatuese ndërkombëtare sidomos për kryerjen e hetimeve pasurore financiare që lidhen me veprat penale të korrupsionit;

Në rastet kur ka lindur e nevojshme kryerja e verifikimeve për persona të caktuar, nga ana jonë është kërkuar informacion Zyrës së Interpolit në Tiranë në lidhje me faktin nëse ka të dhëna për aktivitetin kriminal, apo nëse rezultojnë të dënuar për ndonjë veprë penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Kur rezulton se personi për të cilin është kërkuar informacioni është dënuar apo ka qenë i dyshuar për kryerjen e ndonjë veprë penale, nga ana jonë mbështetur në nenin 509 të K.Pr.penale është proceduar me kërkesa për ndihmë juridike, letërpororsi, drejtuar autoriteteve të huaja të drejtësisë.

2.5 Përmirësimi i cilësisë së hetimeve të kryera me qëllim rritjen jo vetëm të personave të dërguar për gjykim por edhe rritje të personave të dënuar me vendim të formës së prerë;

Gjatë vitit 2018 ka pasur një rritje të ndjeshme jo vetëm të materialeve të referuara por edhe të çështjeve të dërguara për gjykim dhe personave të dënuar me vendim të formës së prerë.

Viti	Çështje të derg. per gjykim	Të pandehur	Të arrestuar
2016	291	338	41
2017	273	305	20
2018	350	391	18

Viti	Çështje të gjykuara	Të pandehur
2016	290	318
2017	287	321
2018	348	376

Urdhra ekzekutimi

	Burg	Gjobë	Neni 59	Neni 63	Masë mjekësore	Bashkim dënimesh	Të tjera	TOTALI
Viti 2017	55	79	52	6	2	0	22	216
Viti 2018	58	131	113	5	3	0	44	354

Sikurse shihet nga tabelat e mësipërme numri i çështjeve të dërguara për gjykim, numri i çështjeve të gjykuara si dhe numri i vendimeve të formës së prerë përgjatë vitit 2018 është shumë herë më i lartë se gjatë vitin 2017 apo vitit 2016.

2.6 Ashpërsim të politikës penale në drejtim të masave të sigurimit dhe atyre të dënimit;

Gjithashtu gjatë vitit 2018 janë paraqitur në gjykatë 148 kërkesa për vleftësim arresti dhe caktim Mase Sigurimi, apo vetëm kërkesë për caktimin e Masës së Sigurimit. Ndërkohë rezulton se përgjatë vitit 2017 janë paraqitur në gjykatë 105 kërkesa të tilla, me një **rritje nga viti 2017 në vitin 2018 prej 29 %**. Sikurse shihet nga tabela më poshtë konstatohet se ka një rritje të masave të sigurimit “Arrest në burg në mungesë” nga 4 në vitin 2017 në 14 në vitin 2018. Gjithashtu rezulton të ketë një rritje të ndjeshme të masës së sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” parashikuar nga neni 234 i Kodit Penal, e dhënë e cila lidhet ngushtësisht me rritjen e referimeve me arrest në flagrancë për veprën penale të “Drejtimit të automjetit në mënyrë të parregull” parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

VITI 2017

Lloji i masës	238	238 me afat	238 ne mungesë	237	234	Totali
Prokurori	68	7	4	13	13	105
Gjykata	54	8	3	25	12	105

VITI 2018

Lloji i masës	238	238 me afat	238 ne mungesë	237	234	Totali
Prokurori	68	6	14	12	48	148
Gjykata	55	7	14	21	51	148

2.7 Forcim të kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër korrupsionit;

Prokurorët pranë Prokurorisë së rrethit gjyqësor Dibër me qëllim rritjen e tyre profesionale si dhe për një njohje dhe zbatim sa më efikas të ndryshimeve ka pësuar Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë dhe standardeve të reja të vendosura me hyrjen në fuqi të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur janë angazhuar në sesione trajnuese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, Prokuroria e Përgjithshme etj. Këto trajnime janë pasqyruar me tema konkrete në pikën 10, të Kreut I të këtij raporti statistikor.

2.8 Trajnime të oficerëve të policisë gjyqësore, të cilët janë një hallkë shumë e rëndësishme e hetimeve;

Për të përmirësuar punën, nga ana jonë janë ndërmarrë masa konkrete duke u angazhuar në trajnimin e punonjësve të policisë së komisariateve Dibër, Bulqizë dhe Mat si dhe punonjësve të policisë së Drejtorisë Vendore Dibër. Kështu më datë 16.02.2018, nën kujdesin e Prokurorisë së Përgjithshme është zhvilluar trajnimi me temë “*Ndryshimet ligjore të ndërmarrë për reformën në drejtësi, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penal dhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur*”.

Por sigurisht që kjo masë mbetet e pamjaftueshme dhe kërkohet edhe angazhimi i aktorëve dhe faktorëve të tjerë të cilët duhet të marrin masat e duhura të trajnimit vazhdues të oficerëve të policisë gjyqësore, sikurse procedohet nga Shkolla e Magjistraturës për Magjistratët gjyqtarë apo prokurorë.

2.9 Rritja e aksesit dhe përdorimit të të dhënave në databazat shtetërore;

Aktualisht Prokuroria Dibër ka akses në sistemin TIMS të të dhënave dhe në aplikacionin e-albania vetëm për një grup të kufizuar të dhënash. Rritja e aksesit të prokurorëve tek të dhënat që administrohen nëpërmjet këtyre sisteme ndikon vetëm pozitivisht në rritjen e shpejtësisë dhe efektshmërisë së hetimeve.

Gjithashtu është dhënë vetëm një adresë për aksesimin e të dhënave të Aluiznit, QKL-së dhe Certifikatave Elektronike të Gjendjes Gjyqësore. Vlerësoj se duhet marrë në konsideratë hapja e adresave shtesë për secilin prokuror, pasi pasje e vetëm një adrese sjell vetëm vonesa në marrjen e informacionit të duhur në një kohë sa më të shkurtër dhe në mënyrë sa më efektive.

2.10 Rritjen e cilësisë së mbajtjes dhe raportimit të të dhënave statistikore duke rritur profesionalizmin e burimeve njerëzore dhe zhvillimin e sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit

Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër, ka qenë gjithmonë korrekte në pasqyrimin e të dhënave statistikore, sidomos të të dhënave që kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe korrupsionin

III. Me qëllim forcimin e luftës kundër krimit të organizuar:

- 3.1 Forcim të bashkëpunimit me policinë gjyqësore dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese, me qëllim shkëmbimin e informacionit, kryerjen e analizave dhe vlerësimeve të përbashkëta, me qëllim rritjen e efektivitetit të hetimeve ndaj grupeve të strukturuar kriminale;

Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër, ka punuar me profesionalizëm, përkushtim e korrektësi ligjore për të përmbushur me sukses detyrën e ushtrimit të ndjekjes penale duke bashkëpunuar me policinë gjyqësore dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese.

- 3.2 Hetime sistematike pasurore dhe rritje të numrit të aseteve të konfiskuara, në zbatim të ligjit 10192/2009, ndryshuar me ligjin 70/2017, specifikisht në drejtim të masave parandaluese;

Në të gjitha rastet e referuara për nenin 287 të Kodit Penal është proceduar me hetime sistematike pasurore me qëllim evidentimin e pasurive të vëna dhe kryerjen e hetimeve përkatëse, në kuadër të provueshmërisë së burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e këtyre pasurive. Gjatë vitit 2018 janë hetuar 14 çështje penale për nenin 287 të Kodit penal, një më pak se në vitin 2017.

- 3.3 Rritje të numrit dhe cilësisë së hetimeve për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale dhe atë të pastrimit të parave, në funksion të rritjes së numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim;

- 3.4 Rritjen e bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për grupet e strukturuar kriminale që lidhen sidomos me trafikimin e narkotikëve, pastrimit të parave, financimin e terrorizmit, trafikimin e qenieve njerëzore, në rastet e emigrimit, veçanërisht për kategori vulnerabël si azilkërkuarit dhe personat e mitur të pashoqëruar;

- 3.5 Rritje të numrit dhe të cilësisë së hetimeve duke përdorur teknikat speciale të hetimit;

- 3.6 Ashpërsim të politikës penale në drejtim të masave të sigurimit dhe atyre të dënimit;

- 3.7 Forcim të kapaciteteve profesionale të prokurorëve, por edhe të oficerëve të policisë gjyqësore;

- 3.8 Rritja e aksesit dhe e përdorimit të të dhënave në databazat shtetërore, në funksion të shpejtësisë dhe efektivitetit të së hetimeve;

- 3.9 Rritjen e cilësisë së mbajtjes dhe raportimit të të dhënave statistikore duke rritur profesionalizmin e burimeve njerëzore dhe zhvillimin e sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit.

Sqarimet në lidhje me pikat e mësipërme janë dhënë në pikat përkatëse të rekomandimeve prioritare “*Me qëllim forcimin e luftës kundër korrupsionit*”

IV. Me qëllim respektimin e të drejtave të njeriut të subjekteve të procedimit penal:

- 4.1 Zbatimin e kuadrit të ri ligjor lidhur me drejtësinë për të mitur në funksion të garantimit të procesit të rregullt ligjor, aplikimit të masave alternative të shmangies nga ndjekja penale;

Në lidhje me Drejtësinë Penale për të Mitur janë marrë masa për zbatimin e parashikimeve që janë në fuqi prej datës 01.01.2018 ku në raste e parashikuara me ligj është zbatuar masa alternative e shmangies nga dënimi kryesisht për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit penal. Gjithashtu janë zbatuar edhe parashikimet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur edhe në raport me llojin e masave të sigurimit që janë aplikuar për të miturin në konflikt me ligjin.

Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër gjatë vitit 2018 ka regjistruar gjithsej 31 procedime penale me 43 të pandehur, 28 nga të cilët të mitur (25 meshkuj dhe 3 femra), 3 të grup moshës 14-16 vjeç dhe 25 të grup moshës 16-18 vjeç. Të miturit në konflikt me ligjin janë hetuar në gjendje të lirë dhe në dy raste përkatësisht për nenin 278/1 dhe 290/3 të Kodit Penal është caktuar ndaj tyre masa e sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” parashikuar nga neni 234 i Kodit Penal, në zbatim të neneve 81-87 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Në përfundim të hetimeve, për 12 procedime penale me 14 të mitur në konflikt me ligjin është vendosur pushimi i çështjes, për shkak se ndaj të miturit në konflikt me ligjin, është zbatuar masa e shmangies nga ndjekja penale. Për 11 procedime penale me 14 të pandehur është kërkuar dërgimi i çështjes në gjyq. Gjithashtu është kërkuar pushimi i çështjes për një të mitur në konflikt me ligjin, është kërkuar pushimi i çështjes për një procedim penal me viktimë të mitur (*çështja vazhdon në gjykim*) dhe për 1 procedim me viktimë të mitur është vendosur pushimi i procedimit penal, pasi në bazë të nenit 59 të Kodit Penal çështja duhet të ndiqej kryesisht në gjykatë nga ana e viktimës akuzuese.

- 4.2 Hetime të shpejta dhe respektim të të drejtave dhe garancive procedurale si në drejtim të të miturit në konflikt me ligjin, të mitur dëshmitar dhe viktima të veprës penale;

Sikurse u sqarua edhe më sipër Prokuroria pranë Gjykatës së shkallës së parë Dibër, ka vendosur zgjatjen e afateve të hetimit **vetëm për 2.4% të çështjeve** të hetuara përgjatë vitit 2018, tregues i rëndësishëm për hetime të shpejta dhe efektive

- 4.3 Përmirësimi i aftësive profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve të ngarkuar me hetimin e çështjeve që lidhen me drejtësinë penale për të mitur;

Për të përmirësuar punën, nga ana jonë janë ndërmarrë masa konkrete duke u angazhuar në trajnimin e punonjësve të policisë së komisariateve Dibër, Bulqizë dhe Mat si dhe

punonjësve të policisë së Drejtorisë Vendore Dibër. Kështu më datë 16.02.2018, nën kujdesin e Prokurorisë së Përgjithshme është zhvilluar trajnimi me temë “*Ndryshimet ligjore të ndërmarra për reformën në drejtësi, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penal dhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur*”

- 4.4 Hetime të shpejta, efektive dhe ashpërsim të politikës së dënimit për veprat penale të dhunës në familje;

2017	Neni 130/a dënim me burg			
	Minimum	Mesatar	Maksimum	Neni 59
Prokurori	--	18	1	14
Gjykata	2	11	1	11

2018	Neni 130/a dënim me burg			
	Minimum	Mesatar	Maksimum	Neni 59
Prokurori	--	15	--	4
Gjykata	--	9	1	8

- 4.5 Zbatimin e kuadrit të ri ligjor në funksion të garantimit të procesit të rregullt ligjor për viktimat e veprës penale në përgjithësi dhe në veçanti për viktimat e dhunës në familje;

Me ndryshimet e reja të Kodit të Procedurës Penale nga ana jonë janë marrë masa për zbatimin e të gjitha parashikimeve që kanë të bëjnë me garantimin e të drejtave të personit nën hetim dhe viktimës së veprës penale duke caktuar mbrojtës kryesisht në rastet kur nuk ka pasur një të zgjedhur. Në praktikë ndihet mungesa e institucioneve që ofrojnë ndihmën juridike falas, të cilat ndonëse janë parashikuar nga Kodi i Procedurës Penale nuk janë krijuar ende

V. Me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional:

- 5.1 Rritjen e bashkëpunimit me policinë e shtetit dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese në funksion të hetimit të specializuar, të shpejtë dhe të gjithanshëm të grupeve kriminale me rrezikshmëri të lartë shoqërore, në fushën e krimit të organizuar dhe, kryesisht grupet kriminale të trafikimit të narkotikëve, krimeve të rënda me ndikim të lartë shoqëror, krimit kundër korrupsionit dhe atij financiar, sekuestrimin e aseteve kriminale;

Bashkëpunimi me këto Institucione ka qenë shumë i ngushtë, për një qëllim të përbashkët, parandalimin e krimeve, evidentimin dhe dokumentimin e tyre, vënien e autorëve para përgjegjësisë penale dhe ndëshkimin e tyre sipas ligjit me qëllim, parandalimin e përgjithshëm dhe të posaçëm të veprave penale në të ardhmen.

Gjatë vitit 2018, në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Dibër, ka marrë masa për realizimin e përgjimeve të telekomunikimeve për të gjitha çështjet ku plotësoheshin kushte dhe kriteret ligjore dhe në disa prej tyre ka pasur rezultate të mira në interes të hetimit.

- 5.2 Forcimin e bashkëpunimit me të gjitha agjencitë ligjzbatuese dhe institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare në funksion të hetimeve proaktive që lidhen me veprat penale në fushën e korrupsionit, pastrimit të parave, pastrimit të ardhurave nga aktivitetet kriminale dhe terrorizmit;

Në rastet kur ka lindur e nevojshme kryerja e verifikimeve për persona të caktuar, nga ana jonë është kërkuar informacion Zyrës së Interpolit në Tiranë në lidhje me faktin nëse ka të dhëna për aktivitetin kriminal, apo nëse rezultojnë të dënuar për ndonjë veprë penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Kur rezulton se personi për të cilin është kërkuar informacioni është dënuar apo ka qenë i dyshuar për kryerjen e ndonjë veprë penale, nga ana jonë mbështetur në nenin 509 të K.Pr.Penale është proceduar me kërkesa për ndihmë juridike, letërpororsi, drejtuar autoriteteve të huaja të drejtësisë.

- 5.3 Forcimin e bashkëpunimit me oficerët e policive gjyqësore të të gjitha agjencive ligjzbatuese me qëllim udhëheqjen, mbikëqyrjen, kryerjen e analizave periodike për evidentimin e praktikave të mira dhe problematikave, në funksion të rritjes së cilësisë së kryerjes së veprimeve hetimore dhe dokumentimit të tyre;

Bashkëpunimi me këto Institucione ka qenë shumë i ngushtë, për një qëllim të përbashkët, parandalimin e krimeve, evidentimin dhe dokumentimin e tyre, vënien e autorëve para përgjegjësisë penale dhe ndëshkimin e tyre sipas ligjit me qëllim, parandalimin e përgjithshëm dhe të posaçëm të veprave penale në të ardhmen.

Numri më i madh i procedimeve penale të regjistruara, rrjedh nga referimi e strukturave të policisë së shtetit, gjithsej **1021** referime të veprave penale nga **899** të referuara vitin e kaluar. Një kujdes i veçantë i është treguar dhënies së udhëzimeve dhe detyrave për oficerët e policisë gjyqësore ne strukturat e policisë së shtetit që janë deleguar për hetimin e çështjeve penale te referuara nga ana e tyre.

Konstatohet dukshëm që numri i çështjeve të referuara nga policia e shtetit është shumë më i ulët se numri i çështjeve të referuara nga polici të tjera, i cili është thuajse i papërfillshëm, ku numrin më të madh të rasteve e zënë referimet nga Drejtoria e Hetimit Tatimor, Rajoni Verior Shkodër për nenet 180 dhe 181 të Kodit Penal.

- 5.4 Rritjen e rasteve të përfshirjes në kryerjen e veprimeve të përbashkëta hetimore të oficerëve të shërbimeve të tjera të policive gjyqësore¹, sidomos për rastet e referuara në prokurori prej tyre; Trajnime të përbashkëta me oficerët e policive gjyqësore në drejtim të teknikave speciale dhe hetimeve komplekse që kryhen për hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar, pastrimit të parave, krimeve financiare, evazionit fiskal dhe veprave penale ushtarake;

Në të gjitha rastet kur një material kallëzues është referuar nga polici të tjera, pas regjistrimit të procedimeve përkatëse materiali i është deleguar për veprim po të njëjtës polici. Sikurse u theksua më sipër numrin më të madh të këtyre çështjeve e zënë referimet nga Drejtoria e Hetimit Tatimor, Rajoni Verior Shkodër për nenet 180 dhe 181 të Kodit Penal, por për shkak se vendndodhja e këtij institucioni është në qyteti e Shkodrës, mbetet i vështirë komunikimi për shkak të largësisë dhe moslidhjes si gjeografike ashtu edhe infrastrukturore. Komunikimi me këtë institucion është kryesisht shkresor.

- 5.5 Forcim i bashkëpunimit në funksion të hetimeve të shpejta dhe forcimit të masave ndëshkuese nga prokuroria për veprat penale në fushën e mjedisit, me qëllim shmangien e katastrofave mjedisore dhe parandalimin e dëmtimit të mjedisit;

Për veprat penale kundër mjedisit, kryesisht regjistruara për veprën penale të “*Prerjes së paligjshme të pyjeve*” parashikuar nga neni 205 i Kodit penal, nga ana jonë në çdo rast është marrë vendim për kryerjen e ekspertimeve vlerësuese me qëllim përcaktimin e kategorisë së pasojës së ardhur dhe në të gjitha rastet kur ka rezultuar se pasoja e ardhur nuk mund të kualifikohet si vepër penale, një kopje e vendimmarrjes i është përcjellë edhe ISHPMU me qëllim marrjen e masave administrative;

VKM-ja **nr.108, datë 27.01.2009** “*Për kriteret e cilësimit të shkeljeve, me pasoja të rënda në pyje*” përcakton rastet se kur dëmtimi apo prerja e pyjeve do të konsiderohet me pasoja të rënda, element i cili shërben për kualifikimin e faktit si vepër penale ose si kundërvajtje administrative. Sa më sipër nga ana jonë pasi janë administruar aktet e ekspertimit teknik vlerësues në lidhje me llojin e dëmit, i përcaktuar nga eksperti sipas parashikimeve të VKM-së së sipërcituar, është vendosur marrja e personit në përgjegjësi penale ose pushimi i çështjes. Për të gjitha rastet kur është vendosur pushimi i çështjes nga ana jonë janë marrë masa për referimin e rastit tek **Inspektorjati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujrave** për marrjen e masave administrative në bazë të nenit 38 të ligjit nr.9385 datë 04.05.2005 “*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*” dhe ligjit nr.5/2016 “*Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë*”.

¹ Oficerët e policisë gjyqësore së Ministrisë së Financave (hetimit tatimor, doganave), Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Brendshme.

- 5.6 Forcim i bashkëpunimit në funksion të rritjes së efektivitetit të hetimeve ndaj subjekteve që priren të kryejnë evazion fiskal, por edhe nëpunëseve publikë të administratës tatimore:

Në lidhje me raste e referuar nga ana e Drejtorisë së Hetimit Tatimor nga ana jonë janë regjistruar procedimet penale përkatëse, ku rezulton se për vitin 2018 janë regjistruar 11 procedime për nenin 180 dhe 1 procedim për nenin 181 të Kodit Penal. Ndërkohë që në vitin 2017 janë regjistruar 3 procedime për nenin 180 dhe 4 procedime për nenin 181 të Kodit Penal.

- 5.7 Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet drejtorive përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme me qëllim shkëmbimin në kohë reale të informacionit, përmirësimin e cilësisë së akteve dhe shpejtësisë së kryerjes së veprimeve procedurale, në kuadër të ekzekutimit të ekstradimeve dhe letërporosive, në mënyrë të veçantë për çështjet e korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Gjatë vitit 2018 janë ekzekutuar 23 letër-porosi nga jashtë shtetit, në përgjithësi për njoftim të akteve personave të dënuar etj

- 5.8 Forcim të koordinimit ndërinstitucional për të dhënat statistikore në fushën e veprave penale të korrupsionit, krimin të organizuar, pastrimit të parave, krimeve financiare, evazionit fiskal.

Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Dibrë është angazhuar maksimalisht në përpilimin e statistikave të sakta për çdo tre muaj të vitit 2018 si dhe në përpilimin e statistikave përfundimtare për vitin 2018. Një rëndësi e veçantë është treguar për statistikën që ka të bëjë me veprat penale në fushën e krimin të organizuar dhe korrupsionit.

- 5.9 Forcimi i bashkëpunimit me autoritet gjyqësore dhe agjencitë ligjzbatuese të huaja dhe vendëse në drejtim të përmirësimit të luftës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Kërkesat për ndihmë juridike drejtuar autoriteteve të huaja të drejtësisë kanë qenë jo të pakta dhe përgjatë vitit 2018 është konstatuar një rritje e angazhimit nga ana e këtyre autoriteteve në ekzekutimin e letërporosive.

Sikurse është theksuar më sipër këtu vlen të përmendet angazhimi i autoriteteve maqedonase dhe greke të drejtësisë, ku para vitit 2018 përgjigjet e ardhura nga ana e këtyre autoriteteve kanë qenë sporadike ose kanë munguar tërësisht, por gjatë vitit 2018 ka pasur një angazhim serioz nga ana e këtyre autoriteteve në ekzekutimin e letërporosive dhe brenda një afati relativisht të shkurtër.

1.9 Informacion statistikor mbi çështjet penale që lidhen me procesin e verifikimit të Integritetit të Personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë Funksione Publike;

Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër ka regjistruar tre procedime penale për veprën penale të “*Falsifikimit të formularëve, vulave apo stampave*” parashikuar nga neni 190/1 i Kodit Penal **që lidhen me procesin e verifikimit të Integritetit të Personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë Funksione Publike**, ku dy çështje janë dërguar për gjykim dhe të pandehurit janë dënuar, ndërsa për çështje tjetër vazhdon hetimi.

1.10 Të dhëna për temat dhe numrin e trajnimeve të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, apo të përbashkëta me policinë e shtetit;

Prokurorët e Prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër janë angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në sesione trajnuese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, Prokuroria e Përgjithshme apo aktorë të tjerë të angazhuar në trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, me qëllim rritjen profesionale të tyre. Pjesëmarrjet e prokurorëve dhe Oficerëve të policisë gjyqësore në sesione trajnuese është si më poshtë:

Esmeralda Cami, Drejtuese e Prokurorisë

08-09.01.2018	Veprat penale në kushtet e tronditjes psikike. Vështrim krahasues me mbrojtjen e nevojshme dhe të drejtën ndërkombëtare penale.;
16.02.2018	Trajnim i punonjësve të policisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër, me temë “ <i>Ndryshimet ligjore të ndërmarra për reformën në drejtësi, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penal dhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur</i> ”;
20-24.02.2018	Vizitë studimore në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, mbi marrëveshjen dy palëshe për transferimin e personave të dënuar;
06.06.2018	Rishikimi i vendimit të formës së prerë në Procesin Penal. Risitë e Kodit Procedural Penal (neni 449, 450, i ndryshuar i KPP-së). Zbatimi i vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si shkak i domosdoshëm për rigjykimin e çështjes dhe rishikimin e vendimit të formës së prerë penale.;
04-05.07.2018	Raporti prokurori - gjykatë për mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake. Roli i prokurorit në drejtimin dhe kontrollin e hetimeve paraprake; Kerkesa për gjykim e prokurorit dhe seanca paraprake. Pavlefshmerite e akteve dhe shqyrtimi i tyre gjate kesaj seance...;
20.07.2018	Bashkëpunimi ndërinstucional me policinë e shtetit dhe prokurorinë, problematika e hasur dhe raporti MONEYVAL. Ndjekja e çështjeve të filluara nga DPPPP, ligji antimafia dhe trajtimi i çështjeve të nisura nga zyrat e prokurorive në rrethe dhe Prokuroria për krime të rënda;

- 05.10.2018 Koferencë shkencore “*Sfida të zbatimit të standarteve europiane në lirinë e shprehjes në kontekstin shqiptar*”;
- 01-02.11.2018 Mbi disa amandime të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (Ligji antimafia);
- 21.11.2018 Prezantim i risive të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”

Belina Kryemadhi (Zeneli), prokurore

- 15.03.2018 Përgjimi si mjet për kërkimin e provës në procesin penal. Përdorimi i përgjimit; Vendimi për Lejimin e Përgjimit si mjet për kërkimin e provës në procesin penal; Problemet e dala në praktikën gjyqësore shqiptare për vlerësimin e kësaj prove; Standardet ndërkombëtare dhe praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës së Lartë.;
- 21-22.02.2018 Drejtësia penale për të mitur. Standartet ndërkombëtare lidhur me parimet e drejtësisë miqësore për të miturit dhe risitë e legjislacionit shqiptar...;
- 24-25.04.2018 I pandehuri i penduar si bashkëpunëtor i drejtësisë. Pozicioni procedural i të pandehurit bashkëpunëtor i drejtësisë si "dëshmitar" në proces; Rëndësia dhe roli i dëshmitarit me identitet të fshehur në procedimin penal; Vlera provuese e deklarimeve;
- 23-24.05.2018 Mbrojtja nga dhuna në familje në aspektin civil dhe penal. Problemet e praktikës ligjore në rastet e urdhrit të mbrojtjes dhe urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes; Rrethi i subjekteve që gëzojnë mbrojtje nga ligji nr. 9669/2006 dhe subjekteve të mbrojtura nga neni 130/a të Kodit të Familjes; Trajtimi i rrethanave cilësuese të nenit 130/a të Kodit Penal;
- 30-31.05.2018 Krimi kibernetik. Evidentimi i krimit kibernetik; Procedimi Penal në rastet e krimit kibernetik: dëshmitë elektronike; Të ardhurat nga krimi online; Përdorimi i internetit për qëllime terroriste.;
- 29.06.2018 Raporti i gjykatës dhe prokurorisë me median. Roli i magjistratit të shtypit në balancimin e interesit të palëve në proces dhe interesit publik për të marrë informacion. Kufijtë etikë dhe profesional.

Rifat Kojku, prokuror

- 08-09.01.2018 Veprat penale në kushtet e tronditjes psikike. Vështrim krahasues me mbrojtjen e nevojshme dhe të drejtën ndërkombëtare penale.;
- 06.06.2018 Rishikimi i vendimit të formës së prerë në Procesin Penal. Risitë e Kodit Procedural Penal (neni 449, 450, i ndryshuar i KPP-së). Zbatimi i vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si shkak i domosdoshëm për rigjykimin e çështjes dhe rishikimin e vendimit të formës së prerë penale.;

- 04-05.07.2018 Raporti prokurori - gjykatë për mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake. Roli i prokurorit në drejtimin dhe kontrollin e hetimeve paraprake; Kërkesa për gjykim e prokurorit dhe seanca paraprake. Pavlefshmerite e akteve dhe shqyrtimi i tyre gjate kesaj seance. ...;
- 21.11.2018 Aktivitet i organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim me objekt "Llogaridhënie publike për parandalimin e krimit";

Shkëlzen Cena, prokuror

- 12.01.2018 Njoftimet e veçanta dhe me mjete të tjera teknike. Kuadri ligjor lidhur me njoftimet me fokus në nenet 133 - 142/a të Kodit të Procedurës Penale; Njoftimi për herë të parë i të pandehurit të lirë; Njoftimi i të pandehurit person juridik; Njoftimi i personave të huaj që gëzojnë imunitet.
- 24-25.01.2018 Raporti prokurori - gjykatë për mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake. Roli i prokurorit në drejtimin dhe kontrollin e hetimeve paraprake; Kërkesa për gjykim e prokurorit dhe seanca paraprake. Pavlefshmerite e akteve dhe shqyrtimi i tyre gjate kesaj seance...;
- 26-27.03.2018 Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja. Ekstradimi; Arresti i përkohshëm; Njohja e vendimit penal të huaj për të gjykuarin në mungesë "in absentia" nga Autoriteti Gjyqësor i Huaj.
- 08-09.06.2018 Mbi rolin e kryetarëve të gjykatave;
- 26.10.2018 Investigimi i rasteve që lidhen me sigurinë e gazetarëve (ëorkshop tematik për prokurorë përfshirë përfaqësues të ligjit).

Urim Buci, prokuror

- 15-16.03.2018 Përgjimi si mjet për kërkimin e provës në procesin penal. Përdorimi i përgjimit; Vendimi për Lejimin e Përgjimit si mjet për kërkimin e provës në procesin penal; Problemet e dala në praktikën gjyqësore shqiptare për vlerësimin e kësaj prove; Standardet ndërkombëtare dhe praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës së Lartë.;
- 14-15.05.2018 Mbi narkotikët (diferenca mes trafikut të narkotikëve dhe atij të kryer në kuadër të grupit të strukturuar apo organizatave kriminale;
- 29.06.2018 Res iudicata;

Aldo Puca, oficer i policisë gjyqësore

- 14-15.05.2018 Mbi narkotikët (diferenca mes trafikut të narkotikëve dhe atij të kryer në kuadër të grupit të strukturuar apo organizatave kriminale;

1.11 Problematikat e hasura.

Një problematikë e evidentuar dhe e vazhdueshme në raport me Shërbimet e Policisë Gjyqësore, është përgatitja profesionale e tyre, për sa i përket hetimit të çështjeve të deleguara në raport me zbatimin e ligjit procedural në kryerjen e veprimeve hetimore që lë për të dëshiruar. Sidomos me ndryshimet e pësuara në Kodin e Procedurës Penale, janë evidentuar raste të moszbatimit të neneve 34/a e 34/b të këtij Kodi, etj. Janë të shpeshta rastet kur nuk respektohet afati i lënë nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore, ku në lidhje me këtë problematikë është kërkuar rritja e kontrollit nga drejtuesit e seksioneve.

Problem konstant për prokurorinë Dibër mbetet mungesa e ekspertëve, kryesisht ekspertëve mjekoligjorë. Territori i Komisarariatit të Policisë Bulqizë mbulohet nga një mjek i Spitalit Rajonal Burrel ndërsa për bashkinë Dibër nuk ka një mjek ligjor dhe rastet e ekspertimit mbulohen nga ana e Institutit të Mjekësisë Ligjore, ku bashkëpunimi ka qenë shumë i mirë, por për shkak të largësisë së bashkisë Dibër nga Tirana, në rastet me pasojë vdekjen, ku prezenca e mjekut ligjor është urgjente, mungesa e një eksperti të tillë sjell vështirësi jo të pakta gjatë kryerjes së veprimeve të para hetimore.


Gjithashtu në praktikë janë hasur probleme në lidhje me zbatimin e garancive dhe të drejtave të parashikuara nga Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, të cilat janë pasqyruar në mënyrë të detajuar në pikën 5 të Kreut IV të këtij raporti.

KREU II

ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT PËR VITIN 2018

2.1 Volumi i punës në hetim për vitin 2018:

Në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Dibër, përgjatë vitit 2018, janë referuar 1067 materiale kallëzuese që përbën një rritje prej rreth 12 %, në krahasim me vitin 2017, vit në të cilin janë referuar 940 materiale kallëzuese, prej rreth 20.2 %, në krahasim me vitin 2016, vit në të cilin janë referuar 851 materiale kallëzuese/referuese dhe prej 24.5 %, në krahasim me vitin 2015, vit në të cilin janë trajtuar 805 materiale kallëzuese/referuese.



Janë ndjekur në hetim gjithsej 858 procedime penale, 3 procedime me shumë se viti 2017, në të cilin janë ndjekur 855 procedime penale (*Këtu përfshihen edhe 170 procedimet penale të mbartura në vitin 2018 nga vitet e tjera*). Për shkak të numrit të lartë të materialeve kallëzuese të mbartura nga viti 2018 për në vitin 2019 (*191 materiale kallëzuese*), numri prej 858 procedimesh penale nuk pasqyron ngarkesën efektive të Prokurorisë Dibër për vitin 2018, ku siç u pasqyrua edhe në grafikun më sipër, numri i referimeve ka ardhur vetëm në rritje.

Janë mbartur nga viti 2018 dhe nga vitet e kaluara për në vitin 2019, gjithsej 257 procedime nga 170 procedime penale që ishin mbartur në vitin 2017 nga vitet e kaluara.

Është vendosur mosfillimi për 215 referime dhe kallëzime penale te vitit 2018, 171 raste më pak se në vitin 2017, ku ishte vendosur mosfillimi i procedimit penal për 386 kallëzime/referime. Nuk ka pasur çështje te regjistruara për vepra penale te parashikuara ne Kodin Penal Ushtarak.

Volumi i punës në hetim i organit të prokurorisë Dibër, për vitin 2018 paraqitet si vijon:

Procedime penale	Nr. i procedimeve	Persona nen hetim	Të pandehur	Të arrestuar
Të mbartura nga viti 2017	170	32	60	1
Të regjistruara vitit 2018	587	133	241	30
Të rifilluar të pushuara	7	4	2	0
Të rifilluar të pezulluara	8	0	1	0
Të ardhur me transferim	86	0	87	0

Gjithsej	858	169	391	31
-----------------	------------	------------	------------	-----------

Krahasuar me 3-mujorin e tretë të vitit 2018, vërehet se në tre-mujorin e katërt i vitit 2018 ka një rritje të materialeve të referuar nga policia e shtetit. Kështu, në 3-mujorin e parë janë referuar nga policia e shtetit 176 materiale, në tremujorin e dytë janë referuar 277 materiale, në tre mujorin e tretë 307 materiale dhe në tre mujorin e katërt 262 materiale, 45 materiale më pak se në tremujorin e tretë.

Krahasimi i referimeve për çdo 3 mujor të vitit 2018:


Periudha	Prokurori	Nëpunësit publik	Shtetasit	Policia e Shtetit
3-mujori i I-rë	-	5	3	176
3-mujori i II-të	1	8	7	277
3-mujori i III-të	-	7	2	307
3- mujori i IV	-	5	7	262
Totali Viti 2018	1	25	19	1022

2.2 Çështje të përfaqësuara në Gjykatën e rrethit gjyqësor Dibër:

Gjatë vitit 2018, nga Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër, është ngritur dhe përfaqësuar akuza në gjykatë në emër të shtetit, duke përfshirë këtu edhe çështjet e mbartura në gjykim, për **465 çështje me 520 të pandehur** 21 prej të cilëve me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Krahasuar me vitin 2017 ku rezulton të jenë përfaqësuar në gjykim **363 çështje penale me 411 te pandehur**, 28 prej te cilëve me mase sigurimi “Arrest ne burg” dhe me vitin 2016, ku janë përfaqësuar **367 çështje me 428 te pandehur**, 52 prej te cilëve me mase sigurimi “Arrest ne burg” konstatohet se ka një rritje të dukshme të çështjeve të përfaqësuara në gjykim në një masë prej rreth **22%**, kjo edhe për shkak të ndryshimeve që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale me ligjin nr.35/2017 datë 30.03.2017, i cili ka hyrë në fuqi më datë 01.08.2017.

Viti	Çështje të përfaqësuara në gjykim	Të pandehur	Të arrestuar
2016	367	428	52
2017	363	411	28
2018	465	520	21



Rezulton se gjatë vitit 2018 janë përfunduar në gjykim gjithsej 348 çështje penale me 376 të pandehur, ku në krahasim me vitin 2017 ku janë përfunduar 287 çështje me 321 të pandehur, rezulton se ka një **rritje 17.5 %** të numrit të çështjeve të përfunduara në gjykim nga viti 2017 në vitin 2018.

Gjithashtu gjatë vitit 2018 janë paraqitur në gjykatë 148 kërkesa për vleftësim arresti dhe caktim Mase Sigurimi, apo vetëm kërkesë për caktimin e Masës së Sigurimit. Ndërkohë rezulton se përgjatë vitit 2017 janë paraqitur në gjykatë 105 kërkesa të tilla, me një **rritje nga viti 2017 në vitin 2018 prej 29 %**.

2.3 Treguesit kryesor të punës së prokurorisë Dibër vitin 2018:

2.3.1 PROCEDIME PENALE TË REGJISTRUARA

Nga të dhënat statistikore, rezulton se gjatë 9-mujorin e parë të vitit 2018, janë regjistruar rishtazi 587 (*pesëqind e tetëdhjetë e shtatë*) procedime penale, janë rifilluar 7 çështje të pushuara, 8 çështje të pezulluara si dhe kanë ardhur për kompetencë nga prokurori të tjera 86 procedime penale. Sikurse u sqarua edhe më sipër për shkak të numrit të lartë të materialeve kallëzuese të patrajtuara të mbartura nga viti 2018 dhe vite të tjera për në vitin 2019, themi se numri prej 587 procedimesh penale nuk pasqyron ngarkesën efektive të Prokurorisë Dibër për vitin 2018

2.3.2 MOSFILLIMET

Në lidhje me referimet dhe kallëzimet për të cilat është vendosur mosfillimi, nga të dhënat statistikore, rezulton se në vitin 2018, është vendosur mosfillimi i procedimit për 215 referime dhe kallëzime penale, 171 vendime më pak se në vitin 2017 ku është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 386 materiale kallëzuese.

Pjesa më e madhe e mosfillimeve ka qenë për veprat penale kundër shëndetit si rrahja. Ky tregues shpjegohet ndër të tjera me faktin se ndodhemi para veprave penale të cilat ndiqen me ankim, për të cilat prokuroria nuk është organ i ndjekjes penale, si dhe rasteve kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

Përgjatë vitit 2018 janë cënauar nga gjykata 8 vendime mosfillimi ku është vendosur të pranohet ankimi i kallëzuesit duke urdhëruar Prokurorinë të regjistrojë procedimin dhe të vazhdojë hetimet. Nga këto, në tre raste pas përfundimit të hetimit është kërkuar pushimi i hetimeve, në një rast është vendosur dërgimi i çështjes në gjyq dhe në katër raste të tjera vazhdojnë hetimet.

2.3.3 PROCEDIMET PENALE TË PUSHUARA

Gjatë vitit 2018 Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër ka vendosur pushimin ose ka kërkuar pushimin para Gjykatës së shkallës së parë Dibër për 133 çështje me 52 persona nën hetim, 122 çështje më pak se në vitin 2017, pra **ka një rënie prej thujse 92 % të vendimeve të pushimit** apo kërkesave për pushim.

Kjo rënie lidhet ngushtësisht me vendimet apo kërkesat për pushim për shkak të kalimit të afateve të parashkrimit të ushtrimit të ndjekjes penale, ku nëse në vitin 2017 ka pasur 84 raste, gjatë vitit 2018 ka pasur vetëm 4 raste. Gjithashtu vihet re një rënie e dukshme e numrit të personave në hetim për të cilët është pushuar çështja nga 109 në vitin 2016 në 52 në vitin 2018.

Viti	Çështje të pushuara	Per. Nën hetim	Të arrestuar
2016	175	109	-
2017	255	78	-
2018	133	52	-

Në të gjitha këto procedime penale janë kryer veprime hetimore të plota dhe në çdo rast është bërë njoftimi i vendimit të pushimit si kallëzuesit, institucioneve apo individëve, dhe palëve të interesuara.

Nga 133 çështje penale të pushuara rezulton se në 75 raste prokurori ka proceduar më paraqitjen e kërkesës për pushim e çështjes para Gjykatës së shkallës së parë Dibër në bazë të nenit 328/1 dhe 329/a të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur pushimin për 54 kundërvajtje penale dhe ka kërkuar pushimin për 4 çështje për të cilat kishte kaluar afati i ushtrimit të ndjekjes penale.

Gjykata e shkallës së parë Dibër nga 75 raste, **nuk ka pranuar kërkesën e prokurorit për pushimin e çështjes në 9 raste** duke urdhëruar kryerjen e **veprimeve hetimore shtesë në 5 raste** ose **njoftimin e akuzës dhe dërgimin e çështjes për gjykim në 4 raste.**

Në 3 raste Gjykata e shkallës së parë Dibër ka vendosur **prishjen e vendimit të prokurorit për pushimin e hetimeve** (çështje penal të viteve 2012, 2015 dhe 2016) duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve.

Duke ju referuar statistikës për grup-veprat penale për të cilat është regjistruar procedimi penal, rezulton se është vendosur pushimi si më poshtë:

Kreu II “Veprat Penale kundër personit”

Nga ana jonë janë pushuar ose është kërkuar pushimi në gjykatë për 18 çështje me 16 persona nën hetim, ku rezulton se numrin më të lartë të çështjeve e zë vepra penale e “Plagosjes së lehtë me dashje” parashikuar nga neni 89 i Kodit penal, me 9 çështje.

Kreu II “Veprat Penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”

Nga ana jonë janë pushuar ose është kërkuar pushimi në gjykatë për 36 çështje me 8 persona nën hetim, ku rezulton se numrin më të lartë të çështjeve e zë vepra penale e “Shkatërrimit të pronës me zjarr” parashikuar nga neni 151 i Kodit penal, me 9 çështje.

Kreu II “Veprat Penale kundër mjedisit”

Nga ana jonë janë pushuar 17 çështje me 5 persona nën hetim, të gjitha të regjistruara për veprën penale të “Prerjes së paligjshme të pyjeve” parashikuar nga neni 205 i Kodit penal.

Duhet sqaruar se VKM-ja **nr.108, datë 27.01.2009** “Për kriteret e cilësimit të shkeljeve, me pasoja të rënda në pyje” përcakton rastet se kur dëmtimi apo prerja e pyjeve do të konsiderohet me pasoja të rënda, element i cili shërben për kualifikimin e faktit si vepër penale ose si kundërvajtje administrative. Sa më sipër nga ana jonë pasi janë administruar aktet e ekspertimit teknik vlerësues në lidhje me llojin e dëmit, i përcaktuar nga eksperti sipas parashikimeve të VKM-së së sipërcituar, është vendosur marrja e personit në përgjegjësi penale ose pushimi i çështjes. Për të gjitha rastet kur është vendosur pushimi i çështjes nga ana jonë janë marrë masa për referimin e rastit tek **Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujrave** për marrjen e masave administrative në bazë të nenit 38 të ligjit nr.9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” dhe ligjit nr.5/2016 “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”.

Duhet theksuar se masa e dënimit me gjobë është shumëfish më e lartë për kundërvajtjen administrative, për të cilën aplikohet një gjobë prej 5 milion lekësh në bazë të ligjit nr.5/2016 “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë” se sa për kundërvajtjen penale ku në bazë të nenit 34 të Kodit penal masa e dënimit me gjobë mund të jetë nga 50 mijë deri në 3 milion lekë.

Kreu VIII “Krimet kundër autoritetit të shtetit”

Nga ana jonë janë pushuar ose është kërkuar pushimi në gjykatë për 60 çështje me 21 persona nën hetim, ku rezultojnë se numrin më të lartë të çështjeve e zë vepra penale e “Shkeljes së rregullave të sigurisë teknike në punë” parashikuar nga neni 289 i Kodit penal, me 21 çështje, “Drejtim të automjetit pa dëshmi aftësie” parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal me 14 çështje dhe “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal me 7 çështje

Vlen të theksohet se ndryshimet që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale me ligjin nr.35/2017 datë 30.03.2017 kanë ndikuar dukshëm në rritjen e numrit të çështjeve të pushuara apo të çështjeve për të cilat kërkohet pushimi para gjykatës. Kështu neni 291 i Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar parashikon se: “Kur ekzistojnë rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e tij, brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit.” Ky afat i parashikuar nga legjislatori rezultojnë të jetë i pamjaftueshëm për administrimin e akteve, të cilat i shërbejnë një vendimmarrje të arsyetuar nga ana e prokurorit.

Në një pjesë të mirë të rasteve mosadministrimi brenda afatit prej 15 ditësh të aktit të ekspertimit mjekoligjor për viktimën e veprës penale, pasjell regjistrimin e procedimit penal për vepra penale të tilla si neni 89, 289 apo 290 i Kodit penal, ku me administrimin e aktit arrihet në përfundimin se çështja në fakt duhet të pushohet për shkak se ndjekja penale nuk është kompetencë e organit të akuzës (neni 90 i Kodit Penal) ose nuk ka ardhur pasoja e kërkuar nga ligji.

Gjithashtu në 12 raste është vendosur pushimi i çështjes në bazë të nenit 55, 56, 58 dhe 67 të ligjit nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të miturit”, si edhe nenit 328 germa “f”, të Kodit të Procedurës Penale, për shkak se ndaj të miturit në konflikt me ligjin, është zbatuar masa e shmangies nga ndjekja penale.

2.3.4 PROCEDIMET PENALE TE PEZULLUARA

Prokuroria Dibër ka vendosur pezullimin e hetimeve në bazë të nenit 326 të K.Pr.Penale, për 103 procedime penale, **16 procedime më pak se në vitin 2017**, fakt i cili tregon rritjen e zbulueshmërisë së autorëve të veprave penale.

Këto procedime janë të ndara me grup veprash si më poshtë:

Vepra penale kundër pasurisë, rezultojnë 89 procedime te pezulluara, 13 procedime më pak se viti 2017, kryesisht janë me vend-ngjarje të referuara nga seksionet e policisë gjyqësore pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër. Në të gjitha rastet është urdhëruar kryerja e veprimeve

hetimore, si dhe deleguar veprime të posaçme dhe në përfundim bazuar dhe në relacionin e oficerëve të policisë gjyqësore është vendosur pezullimi i hetimeve.

Për pjesën tjetër të procedimeve, është vendosur pezullimi i hetimeve për veprat penale në fushën e shkatërrimit të pronës me zjarr, etj. Në asnjë rast nuk është vendosur pezullimi i hetimeve, me autore të regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale. Ulja e numrit të procedimeve penale të pezulluara, ka ardhur edhe si rezultat i marrjes së masave dhe efikasitetit të punës së përbashkët mes prokurorisë dhe policisë. Janë zbuluar disa ngjarje që kishin të bënin me vjedhjen të ndryshme të kryera nga të njëjtët autorë.

Vetëm në një rast vendimi i pezullimit të prokurorit është cënuar nga gjykata, mbi bazën e ankimit të kallëzuesit dhe për këtë çështje vazhdojnë hetimet

2.3.5 PROCEDIMET PENALE TË TRANSFERUARA

Është vendosur transferimi për kompetencë për 15 procedime penale me 12 persona nën hetim, 21 procedime penale më pak se në vitin 2017, kjo për shkak se me hyrjen në fuqi të ligjit nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të miturit” hetimi i çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin, të mitur viktimë apo dëshmitar është realizuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër dhe jo nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Seksionit të të Miturve, pas zgjidhjes së konfliktit të kompetencës nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm.

Sikurse është sqaruar më herët në pikën 2 të kreut I të këtij raporti me hyrjen në fuqi të ligjit nr.37/2017 datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur” dhe pas zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në lidhje me kompetencën për hetimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin apo të miturin viktimë, kompetenca lëndore për këtë kategori çështjesh është përcaktuar në varësi të kompetencës territoriale. Pra Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër ka hetuar të gjitha ngjarjet e ndodhura në territorin e saj ku subjekti i veprës penale ka qenë i mitur apo viktima ka qenë e mitur.

Nga ana e Gjykatës së rrethit gjyqësor Dibër është mbajtur qëndrimi se kompetenca për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin apo të mitur viktimë i përket Seksionit për të Mitur, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe për këtë arsye nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake apo gjyqtari i themelit, pasi konstatohet se i pandehuri është i mitur apo ka qenë i mitur në kohën e kryerjes së veprës penale apo viktima e veprës penale është e mitur, shpall moskompetencën dhe kalon aktet Seksionit për të mitur pranë Gjykatës së shkallës së parë Tiranë.


3.2.6 ÇËSHTJE PENALE TË DËRGUARA PËR GJYKIM

Pas përfundimit të hetimeve janë dërguar për gjykim pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor Dibër, 350 çështje, me 391 të pandehur, 18 prej të cilëve nën masën e sigurimit “Arrest në burg,

ndërkohë që në vitin 217 janë dërguar për gjykim 273 procedime dhe në vitin 2016, 291 procedime penale.

Rezulton se ka një rritje të dukshme të çështjeve të dërguara për gjykim nga viti në vit, ku nga viti 2017 në vitin 2018 **ka një rritje të çështjeve të dërguara për gjykim në masën 22 %**.

Viti	Çështje të derg. per gjykim	Të pandehur	Të arrestuar
2016	291	338	41
2017	273	305	20
2018	350	391	18



Duke ju referuar veprave penale për të cilën janë akuzuar e dërguar për gjykim të pandehurit, rezulton si më poshtë :

Kreu II “Veprat Penale kundër personit” Neni 76-133 i Kodit Penal;

Nga ana jonë janë dërguar për gjykim 46 procedime penale, me 55 të pandehur, 17 prej tyre me masë sigurimi “Arrest ne burg”, 10 çështje penale më shumë se në vitin 2017. Pjesën më të madhe të këtyre veprave e përbëjnë veprat penale kundër familjes parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal me 24 çështje, numër thuajse i barabartë me vitin 2017 me 23 çështje.

Ndërkohë rezulton të kemi një rritje të numrit të çështjeve të dërguara për gjykim për nenin 88 të Kodit Penal nga një Penal nga një çështje në vitin 2017 në 6 çështje në vitin 2018. Gjithashtu është dërguar për gjykim një çështje për nenin 76 të Kodit Penal.

Kreu III “Veprat Penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike” Neni 134-200 i Kodit Penal;

Nga ana jonë janë dërguar për gjykim 84 procedime me 93 të pandehur. Evidentojmë se për nenin 134 të K.Penal janë dërguar për gjykim 7 procedime me 15 të pandehur. Për nenin 143/2 të K.Penal, është dërguar në gjyq një çështje penale me një të pandehur. Ka një rënie të ndjeshme të çështjeve të dëguara për gjykim për veprën penale të “*Mashtrimit në sigurime*” parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal, nga 38 çështje në vitin 2017 në 5 çështje në vitin 2018.

Për veprën penale të “*Vjedhjes së energjisë elektrike*” nga abonentët familjare, parashikuar nga neni 137/1 të Kodit Penal, gjithashtu konstatohet një rënie e dukshme, ku rezulton se janë dërguar për gjykim 12 çështje penale me 12 persona të pandehur, në gjendje të lire, 13 çështje më pak se në vitin 2017.

Për veprën penale të “*Ndërtimit të paligjshëm*” parashikuar nga neni 199/a/1 të Kodit Penal, janë dërguar për gjykim 28 çështje penale me 29 të pandehur të hetuar në gjendje të lire, ndërsa për nenin 199/a/2 të Kodit Penal, janë dërguar për gjykim 5 çështje penale, me 5 persona të marrë në cilësinë e të pandehurit. Për nenin 199/a/3 të Kodit Penal, janë dërguar në gjyq 3 çështje me 3 të pandehur.

Kreu VIII “*Krime kundër autoritetit të shtetit*” Neni 235-299 i Kodit Penal

Prokuroria Dibër ka dërguar për gjykim 218 procedime penale me 240 të pandehur, ku duhet evidentuar rritja me thuajse e çështjeve të dëguara për gjykim nga viti 2017 në vitin 2018 me 125.6%.

Për nenin 248 të Kodit Penal, janë dërguar për gjykim, 2 procedime penale me 6 të pandehur; për nenin 278 të Kodit Penal, 9 procedime penale me 10 të pandehur, për nenin 283/1/2 janë dërguar për gjykim 8 procedime me 14 të pandehur dhe për nenin 284 të Kodit Penal nuk rezulton të ketë pasur çështje të dëguara për gjykim.

Për veprën penale të “*Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor*” neni 290/2/3 të Kodit Penal, janë dërguar për gjykim 6 procedime penale me 8 të pandehur. Për nenin 291 i Kodit Penal, janë dërguar për gjykim, 51 procedime me 51 të pandehur, nga të cilët, 1 me masë sigurimi “arrest në burg”, ndërkohë që në vitin 2017 janë dërguar për gjykim 18 çështje për nenin 291 të Kodit Penal.

Për veprën penale të “*Refuzimi për deklaram, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publik, ose çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram*” parashikuar nga neni 257/a1/2 i Kodit Penal, janë dërguar për gjykim 2 procedime penale me 2 të pandehur.

2.4 TË DHËNA NË LIDHJE MË NJOFTIMET PËR VEPRAT PENALE

Gjatë vitit 2018, të dhënat në lidhje me njoftimet e veprave penale paraqiten si më poshtë: Nga prokurori është filluar kryesisht 1 procedim; nga nënpunësit publikë, janë depozituar 25 kallëzime penale; nga shtetasit janë paraqitur 19 kallëzime; nga policitë e tjera është paraqitur 1 kallëzim dhe në 1021 raste të tjera, pra në pjesën dërrmuese, veprat penale janë referuar nga policia e shtetit.

2.5 TË DHËNAT NË LIDHJE ME MASAT E SIGURIMIT PERSONAL E PASUROR

Nga personat nën hetim, mbi bazën e referimit të akteve paraprake kanë ardhur me masë të përkohshme, “*arrest në flagrancë*“ dhe “*ndalim*“ gjithsej 135 persona të dyshuar për kryerjen e veprave të ndryshme penale, 35 persona me shumë të arrestuar/ndaluar s në vitin 2017.

Është kërkuar vleftësimi i arrestit në flagrancë dhe vleftësimi i ndalimit për të gjithë rastet e arrestimit dhe të ndalimit të personave të dyshuar dhe nga gjykata në çdo rast ka vleftësuar të ligjshëm arrestimin apo ndalimin.

Nga ana jonë është kërkuar caktim masë sigurimi shtrënguese ndaj 148 personave, ku për 68 persona është kërkuar masa e sigurisë “Arrest në burg“ sipas nenit 238 të K.Pr.Penale; për 14 persona është kërkuar caktimi i masës së sigurimit “Arrest në burg” në mungesë; për 12 persona masa e sigurimit “Arrest në shtëpi” sipas nenit 237 të K.Pr.Penale, për 6 persona është kërkuar masa e sigurimit arrest me burg me afat dhe në 35 raste është kërkuar masa e sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore“ sipas nenit 234 të K.Pr.Penale.


Nga ana e Gjykatës për 55 persona është vendosur masa e sigurimit “Arrest në burg”; për 21 persona “Arrest në shtëpi”, për 7 persona “Arrest në burg me afat”, si dhe për 51 persona, është caktuar masa e sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë Gjyqësore”.

Lloji i masës	238	238 me afat	238 ne mungesë	237	234	Totali
Prokurori	68	6	14	12	48	148
Gjykata	55	7	14	21	51	148

2.6 TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË

Në vitin 2018, janë nxjerrë 354 urdhra ekzekutimi vendimesh penale, të dhëna nga Gjykata e rrethit gjyqësor Dibër, ku 58 urdhra janë nxjerrë për vendime dënimi me burgim, 131 urdhra për vendime dënimi me gjobë, 118 urdhra ekzekutimi për dënime alternative dhe 3 urdhra për masë mjekësore. Gjithashtu është urdhëruar ekzekutimi i vendimit të gjykatës në 44 raste për element që kanë të bëjnë me shpenzimet procedurale apo provat materiale të disponuara me vendim gjykate.

	Urdhra ekzekutimi							TOTALI
	Burg	Gjobë	Neni 59	Neni 63	Masë mjekësore	Bashkim dënimesh	Të tjera	
Viti 2017	55	79	52	6	2	0	22	216
Viti 2018	58	131	113	5	3	0	44	354



2.7 KRIMINALITETI SIPAS SHTRIRJES TERRITORIALE TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE NË KOMPETENCË TË PROKURORISË SË RRETHIT GJYQËSOR DIBËR:

Bazuar në Ligjin Nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Qarku i Dibrës përbëhet nga katër Bashki, të cilat janë:

- **Bashkia Dibër**, e cila përbëhet nga qyteti i Peshkopisë dhe 14 njësi administrative, me një popullsi prej **77 199** (*shtatëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë*) banorë;
- **Bashkia Bulqizë**, e cila përbëhet nga qyteti i Bulqizës dhe 7 njësi administrative me një popullsi prej **39 869** (*tridhjetë e nëntë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë*) banorë;
Për vitin 2018, Gjykata ka deklaruar të pafajshëm 1 të pandehur dhe në 5 raste ka vendosur pushimin e çështjes, për çështje penale për të cilat nga ana e prokurorit ishte kërkuar Dërgimi i Çështjes për gjykim.

Krahasuar me vitin 2017, konstatohet një rritje e dukshme e numrit të çështjeve të gjykuara, më konkretisht për vitin 2018, krahasuar me një vit më parë janë gjykuar 348 çështje me 376 të pandehur kundrejt 287 çështjeve me 321 të pandehur të përfunduara gjatë vitit 2017.

Vitet	Shuma	
	Çështje të gjykuara	Të pandehur
2016	290	318
2017	287	321
2018	348	376



Nga Gjykata e rrethit gjyqësor Dibër, për 350 çështje për të cilat është kërkuar dërgimi në gjyq është vendosur pushimi për 5 çështje penale me 6 të pandehur. Sikurse u pasqyruara edhe më sipër nuk rezulton se përgjatë vitit 2018 Gjykata e shkallës së parë Dibër të ketë dhënë pafajësi për çështje penale për të cilat është kërkuar dërgimi i çështjes për gjykim nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër.

Në dy raste Gjykata e shkallës së parë Dibër, gjyqtari i seancës paraprahe, ka vendosur ndryshimin e kualifikimit të faktit duke i kthyer aktet prokurorit. Në një rast është urdhëruar ndryshimi nga neni 85 i Kodit Penal në nenin 76 të Kodit Penal dhe në rastin tjetër është urdhëruar ndryshimi i akuzës nga neni 300 i Kodit Penal në nenin 283/2 i Kodit Penal.

Çështjet e pushuara nga gjykata:

Çështja Nr.480 e vitit 2017, e regjistruar për nenin 130/a/1 të Kodit Penal, ne ngarkim te një te pandehuri Gjykata ka vendosur të pushojë gjykimin. Çështja është hetuar nga prokurore Shkëlzen Cena. Vendimi i Gjykatës është ankimuar në Gjykatën e Apelit Tirane, por nga ana e kësaj gjykate, nuk është marre vendim.

Çështja Nr.300 e vitit 2017, e regjistruar për nenin 145 të Kodit Penal, ne ngarkim te një te pandehuri, Gjykata ka vendosur të pushojë gjykimin. Çështja është hetuar nga prokurore Belina Kryemadhi (Zeneli). Vendimi i Gjykatës është ankimuar në Gjykatën e Apelit Tirane, e cila ka vendosur prishjen e çështjes dhe deklarimin fajtores të të pandehurës.

Çështja Nr.571 e vitit 2017 e regjistruar për nenin 199/a/1 të Kodit Penal, ne ngarkim te një te pandehuri, Gjykata ka vendosur të pushojë gjykimin. Çështja është hetuar nga prokuror Rifat Kojku. Vendimi i Gjykatës është ankimuar në Gjykatën e Apelit Tirane, e cila ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë.

Çështja Nr.309 e vitit 2017, e regjistruar për nenin 181 të Kodit Penal, ne ngarkim te një te pandehuri, Gjykata ka vendosur të pushojë gjykimin. Çështja është hetuar nga prokuror Rifat Kojku. Vendimi i Gjykatës është ankimuar në Gjykatën e Apelit Tirane, por nga ana e kësaj gjykate, nuk është marre vendim.

Çështja Nr.171 e vitit 2018, e regjistruar për nenin 180 të Kodit Penal, ne ngarkim te dy te pandehurve, Gjykata ka vendosur të pushojë gjykimin. Çështja është hetuar nga prokurore Esmeralda Cami. Vendimi i Gjykatës është ankimuar në Gjykatën e Apelit Tirane, e cila ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë.

4.4 TË DHËNA SOCIALE DHE DEMOGRAFIKE PËR TË PANDEHURIT, SI GJINIA, MOSHA, ARSIMI, PUNËSIMI, ETJ:

Nga të dhënat statistikore rezulton së numri i personave të mitur që kryejnë vepra penale është thuhet i njëjtë me vitin 2017, kështu rezulton se janë regjistruar si autorë veprash penale 28 persona të mitur, nga 29 që janë regjistruar në vitin 2017, 25 nga të mituri në konflikt me ligjin janë meshkuj dhe vetëm tre janë femra.

Si zakonisht në të shumtën e rasteve të evidentuara, veprat penale kryhen nga të rriturit dhe në të shumtën e rasteve nga meshkujt. Nga 514 persona të rritur, të cilët kanë marrë statusin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, vetëm 6 prej tyre janë femra.

Në përgjithësi, ka një raport të zhdrejtë në nivelin e arsimit të personave subjekt të një vepre penale. Kështu evidentohet se 344 persona janë me arsim 8 dhe 9-vjeçar, 165 të tjerë janë me arsim të mesëm dhe 16 me arsim të lartë, nga këto 509 të papunë. Vetëm një pjesë e vogël janë të punësuar apo të vetëpunësuar.

Evidentohet se shumica e personave që kryejnë vepra penale banojnë në zonat rurale dhe pjesa tjetër ne qytet. Kështu sipas statistikave, 407 subjekte të veprave penale banojnë ne fshat dhe 117 banojnë në qytetet e Bulqizës dhe Peshkopisë.

4.5 TË DHËNA PËR TË PANDEHURIT E MITUR (NUMRI I PROCEDIMEVE TË REGJISTRUARA)

Qëllimi i Prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër përgjatë vitit 2018, me hyrjen në fuqi të ligjit nr.37/2017 datë 30.03.2017 “*Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur*” ka qenë

promovimi dhe mbrojtja efektive e të drejtave për të miturit në konflikt me ligjin, viktimë, dëshmitar të veprave penale dhe të miturit që nuk kanë mbushur moshën për përgjegjësi penale.

4.5.1 TË DHËNA STATISTIKORE

Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër gjatë vitit 2018 ka regjistruar gjithsej 31 procedime penale me 43 të pandehur, 28 nga të cilët të mitur (25 meshkuj dhe 3 femra), 3 të grup moshës 14-16 vjeç dhe 25 të grup moshës 16-18 vjeç. Të dhënat përfshijnë edhe çështjet penale ku i mituri është viktimë ose dëshmitar.

Të dhënat specifike të ndarë me vepra penale janë si më poshtë:

Neni 89 i Kodit Penal

Prokuroria pranë Gjykatës së shkallës së parë Dibër ka regjistruar një procedim penal me dy **persona nën hetim, të grup moshës 14-16 vjeç**, të cilët njëkohësisht kanë qenë edhe viktimë të veprës penale për nenin 89 të Kodit Penal. Në përfundim të hetimeve është vendosur pushimi i çështjes në bazë të nenit 55, 56, 58 dhe 67 të ligjit nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të miturit”, si edhe nenit 328 germa “f”, të Kodit të Procedurës Penale, për shkak se ndaj të miturit në konflikt me ligjin, është zbatuar masa e shmangies nga ndjekja penale.

Neni 90 i Kodit Penal,

Prokuroria Dibër ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për nenin 90 të Kodit Penal në një rast dhe në një rast tjetër është vendosur pushimi i çështjes, për shkak të mungesës së kompetencës në ushtrimin e ndjekjes penale për këtë kategori veprash. Pjesë e procesit në këto dosje kanë qenë **tre viktimë dhe dy dëshmitarë të mitur**.

Neni 99 i Kodit Penal

Prokuroria Dibër ka vendosur mosfillimin për katër materiale kallëzuese të pasqyruara në tabelën statistikore në rreshtin e nenit 99 të Kodit Penal, por sqarojmë se vetëm në dy raste materiali është referuar nga policia gjyqësore për nenin 99 të Kodit Penal dhe se në dy rastet e tjera materiali është referuar për “largim nga banesa” ku **tre të miturat e larguara nga banesa** kanë qenë të grup-moshës 16-18 vjeç.

Neni 110/2 të Kodit Penal

Prokuroria Dibër ka regjistruar një procedim penal me 6 të pandehur për nenin 110/2 të Kodit Penal, ku **viktimë e veprës penale ka rezultuar të jetë e mitur e grup moshës 14-16 vjeç**.

Neni 124 i Kodit Penal

Përgjatë vitit 2018 Prokuroria Dibër ka regjistruar një procedim penal për nenin 124 të Kodit Penal ku **viktima e veprës penale**, në kohën e kryerjes së saj ka qenë i mitur i grup-moshës 14-16 vjeç;

Neni 130/a/4 dhe neni 124/b/1

Prokuroria Dibër ka regjistruar dy procedime penale për nenin 130/a/4 dhe 124/b/1 ku rezulton se **dhuna është ushtruar njëkohësisht si ndaj bashkëshortes ashtu edhe ndaj fëmijës**. Sa më sipër i pandehuri është marrë në përgjegjësi penale si për nenin 130/a/4 të Kodit Penal ashtu edhe për nenin 124/b/1 për dhunën e ushtruar ndaj fëmijës së mitur. Në tabelën statistikore të dhënat janë pasqyruar në reshtin e neni 124/b/1.

Neni 134/2 i Kodit Penal

Prokuroria Dibër ka regjistruar 2 procedime me **6 persona nën hetim, 4 nga të cilët të mitur**, një i grup moshës 14-16 vjeç dhe tre të grup moshës 16-18 vjeç. Tre nga të mitur në konflikt me ligjin kanë rezultuar të jenë femra dhe çështja penale në ngarkim të tyre është dërguar për gjykim për nenin 134/2 të Kodit Penal dhe nga gjyqtari i themelit ka vendosur shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve Seksionit për të Mitur pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Çështja tjetër është dërguar për gjykim për nenin 134/2 të Kodit Penal në ngarkim të dy të pandehurve madhorë dhe u pushua në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin për shkak se ndaj të miturit u zbatua masa e shmangies nga ndjekja penale. Vlen të theksohet se të miturit në konflikt me ligjin janë hetuar në gjendje të lirë.

Neni 141/a/1 i Kodit Penal

Prokuroria Dibër ka regjistruar një procedim penal për nenin 141/a/1 i Kodit Penal ku rezulton që për ngjarjen **të jetë pyetur një dëshmitar i mitur**.

Neni 273 i Kodit Penal

Prokuroria Dibër ka regjistruar dy procedime penal për nenin 273 të Kodit Penal, ku **viktima e veprës penale ka qenë i mitur**, i grup moshës nën 14 vjeç. Në njërin nga çështjet në përfundim të hetimeve është paraqitur kërkesë në gjykatë për dërgimin e çështjes në gjyq pranë Gjykatës së shkallës së parë Dibër, ku gjyqtari i seancës paraprake ka vendosur shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve Seksionit për të Mitur pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për çështjen tjetër vazhdojnë hetimet.

Neni 278/1 i Kodit Penal

Prokuroria Dibër ka regjistruar një procedim penal për nenin 278/1 të Kodit Penal, ku **autor i veprës penale ka qenë i mitur, i grup moshës 16-18 vjeç** dhe ndaj tij është caktuar masa e sigurimit personal “*Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” parashikuar nga neni 234 i Kodit Penal. Në përfundim të hetimeve është paraqitur kërkesë në gjykatë për dërgimin e çështjes në gjyq pranë Gjykatës së shkallës së parë Dibër, ku gjyqtari i seancës paraprake ka vendosur shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve Seksionit për të Mitur pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Neni 290/1 Kodit Penal

Prokuroria Dibër ka vendosur mosfillimin për dy materiale kallëzuese të referuara për nenin 290/1 të Kodit Penal **ku i dëmtuari ka qenë i mitur**, por nuk ka ardhur pasoja e kërkuar nga lidhje ose ka rezultuar se pasoja ka ardhur si rezultat i shkeljeve të konsumuara nga viktimat. Ndërkohë janë hetuar dy procedime penale të regjistruara për nenin 290/1 të Kodit penal ku në një rast është kërkuar pushimi i çështjes për shkak se nuk ka ardhur pasoja e kërkuar nga ligji dhe për rastin tjetër vazhdojnë hetimet.

Neni 290/3 i Kodit Penal

Prokuroria Dibër ka regjistruar një procedim penal për nenin 290/3 të Kodit Penal, **ku autor i veprës penale ka qenë i mitur, i grup moshës 16-18 vjeç** dhe ndaj tij është caktuar masa e sigurimit personal “*Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” parashikuar nga neni 234 i Kodit Penal. Në përfundim të hetimeve është paraqitur kërkesë në gjykatë për dërgimin e çështjes në gjyq pranë Gjykatës së shkallës së parë Dibër, ku gjyqtari i seancës paraprake ka vendosur shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve Seksionit për të Mitur pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Neni 291 i Kodit Penal

Prokuroria Dibër ka regjistruar **13 procedime penale për nenin 291 të Kodit Penal me autorë të mitur në konflikt me ligjin** dhe në një rast është vendosur mosfillimi i procedimit penal, për shkak se autori i veprës penale nuk kishte mbushur moshën për përgjegjësi penale. Për 11 procedime penale, në përfundim të hetimeve është vendosur pushimi i çështjes në bazë të nenit 55, 56, 58 dhe 67 të ligjit nr.37/2017 “*Kodi i Drejtësisë Penale për të miturit*”, si edhe neni 328 germa “f”, të Kodit të Procedurës Penale, për shkak se ndaj të miturit në konflikt me ligjin, është zbatuar masa e shmangies nga ndjekja penale. Vetëm për dy procedime penale është kërkuar në gjykatë dërgimi i çështjes për gjykim pranë Gjykatës së shkallës së parë Dibër, ku gjyqtari i seancës paraprake ka vendosur shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve Seksionit për të Mitur pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Neni 297 i Kodit Penal

Prokuroria Dibër ka vendosur mosfillimin si procedim penal të materialit kallëzues të referuar për nenin 297 i Kodit Penal, pasi **i mituri nuk kishte mbushur moshën për përgjegjësi penale**. Në një rast është vendosur pushimi i procedimit penal për **dy të mitur në konflikt me ligjin**, për shkak se ndaj të miturit u zbatua masa e shmangies nga ndjekja penale. Gjithashtu është regjistruar edhe një procedim penal me **4 persona nën hetim**, ku një prej tyre është i mitur, çështje për të cilën vazhdojnë hetimet.

Neni 300 i Kodit Penal

Prokuroria Dibër ka regjistruar një procedim penal për nenin 300 të Kodit penal në ngarkim të **katër të miturve në konflikt me ligjin**. Njëri nga të miturit dyshohet edhe për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Hetimet le lidhje me këtë çështje nuk kanë përfunduar.

Në përfundim rezulton se:

- Për 12 procedime penale me 14 të mitur në konflikt me ligjin është vendosur pushimi i çështjes në bazë të nenit 55, 56, 58 dhe 67 të ligjit nr.37/2017 “*Kodi i Drejtësisë Penale për të miturit*”, si edhe neni 328 germa “F”, të Kodit të Procedurës Penale, për shkak se ndaj të miturit në konflikt me ligjin, është zbatuar masa e shmangies nga ndjekja penale;
- Për 11 procedime penale me 14 të pandehur, është kërkuar dërgimi i çështjes në gjyq. Gjithashtu është kërkuar pushimi i çështjes për një të mitur në konflikt me ligjin dhe është kërkuar pushimi i çështjes për një procedim penal me viktimë të mitur (*çështja vazhdon në gjykim*);
- Për 1 procedim me viktimë të mitur është vendosur pushimi i procedimit penal, pasi në bazë të nenit 59 të Kodit Penal çështja duhet të ndiqej kryesisht në gjykatë nga ana e viktimës akuzuese.

4.5.2 PROBLEMATIKAT NË PRAKTIKË

4.5.2.1 Konflikti mbi kompetencën lëndore.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.37/2017 datë 30.03.2017 “*Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur*” dhe pas zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në lidhje me kompetencën për hetimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin apo të miturin viktimë, kompetenca lëndore për këtë kategori çështjesh është përcaktuar në varësi të kompetencës territoriale. Pra Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër ka hetuar të gjitha ngjarjet e ndodhura në territorin e saj ku subjekti i veprës penale ka qenë i mitur apo viktima ka qenë e mitur.

Nga ana e Gjykatës së rrethit gjyqësor Dibër është mbajtur qëndrimi se kompetenca për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin apo të mitur viktimë i përket Seksionit për të Mitur, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe për këtë arsye nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake apo gjyqtari i themelit, pasi konstatohet se i pandehuri është i mitur apo ka qenë i

mitur në kohën e kryerjes së veprës penale apo viktimë e veprës penale është e mitur, shpall moskompetencën dhe kalon aktet Seksionit për të mitur pranë Gjykatës së shkallës së parë Tiranë.

Pra aktualisht, për të gjitha kërkesat e paraqitura nga ana jonë në Gjykatën e shkallës së parë Dibër për çështje penale me të mitur në konflikt me ligjin, apo të mitur viktimë nga ana e kësaj gjykate vendoset shpallja e moskompetencën lëndore dhe vendos kalimin e akteve Seksionit për të Mitur pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë

4.5.2.2 Mungesa e psikologut asistues apo vlerësues të miratuar

Në shtator të vitit 2018 na është vënë në dispozicion një listë Psikologësh asistues dhe vlerësues të kualifikuar nga Urdhri i Psikologut për të marrë pjesë në një proces penal ku është i përfshirë një i mitur në konflikt me ligjin ose një i mitur viktime apo dëshmitar. Nga lista rezulton se për qarkun e Dibrës, nga ana e këtij urdhri janë licencuar vetëm dy psikologë asistues të cilët rezulton se mbulojnë qytetin e Burrelit, i cili është nën juridiksionin e Prokurorisë Mat.

Nga ana jonë është ngritur si shqetësim mungesa e psikologëve asistues dhe vlerësues dhe me shkresën nr.1651/1 prot datë 04.10.2018 i është kërkuar Urdhrit të Psikologut që nga ana e tyre të merren masa për specializimi dhe certifikimin e psikologëve asistues dhe vlerësues të cilët mbulojnë territorin e Bashkisë Dibër dhe Bashkisë Bulqizë, duke na vënë në dispozicion edhe emrat përkatës.

Pavarësisht shqetësimit të ngritur nga ana jonë, rezulton se nga ana e Urdhrit të Psikologut nuk ka pasur reflektim për përmirësimin e situatës, pasi edhe në listën e vënë në dispozicion në muajin janar të vitit 2019 nuk rezulton të ketë asnjë psikolog të miratuar dhe specializuar nga ana e këtij urdhri dhe që ushtron funksionin në territorin e Prokurorisë Dibër.

Në këto kushte Prokuroria Dibër ka hasur vështirësi në përmbushjen e detyrimit që rrjedh nga neni 18 i KDPM i cili parashikon se: “1. Në çdo fazë të procedimit penal me të miturit në konflikt me ligjin, si dhe gjatë pyetjes së të miturit viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga mosha mbi ose nën 14 vjeç, prania e psikologut është e detyrueshme...” dhe për të garantuar të drejtat e të miturit dhe duke pasur në konsideratë një ndër parimet themelore të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur që është edhe “Interesin më të lartë të fëmijës”, ku në nenin 10 të këtij kodi parashikohet se: “Organet kompetente në çdo vendim dhe veprimtari të ndërmarrë në zbatim të këtij kodi, duhet të vlerësojnë me përparësi interesin më të lartë të të miturit...” është garantuar prania e psikologut duke angazhuar psikologun e punësuar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër apo psikologun e Njësisë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

Duhet theksuar se me urdhrin nr.27 datë 21.02.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për strukturën organike të prokurorive të shkallës së parë, prokurorisë për Krime të Rënda dhe Prokurorive të Apeleve” në organikën e Prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër

është miratuar pozicioni i një koordinatori, prezenca e të cilit do të përmirësoj dukshëm trajtimin e çështjeve penale me të mitur viktimë, dëshmitar apo të mitur në konflikt me ligjin.

4.5.2.3 Mungesa e specializimit të personave që administrojnë dhe asistojnë procesin e drejtësisë penale për të mitur.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur nga neni 25 deri në nenin 32, që i përkasin Kreut IV të këtij kodi parashikon trajnimin dhe specializimin e organeve kompetente në procesin e drejtësisë penale për të mitur. Nuk rezulton të jenë krijuar seksione të posaçme për të miturit pranë komisariateve apo drejtorive vendore dhe për pasojë nuk rezulton që nga ana e Akademisë së Sigurisë të jenë marrë masa për trajnimin dhe specializimin e punonjësve të policisë së shtetit të cilët do të punojnë me të mitur. Paqëndrueshmëria e punonjësve të policisë në pozicionin e punës vazhdon të jetë një problem shqetësues;

Nga ana e Dhomës Kombëtare të Avokatisë në bazë të ligjit nr.111/2017 datë 14.12.2017 “*Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti*” dhe në bazë të nenit 31 të KDPM duhet të vënë në dispozicion listën e mbrojtësve të specializuar në drejtësinë për të mitur, e cila aktualisht mungon;

Gjithashtu duhet përmendur si problematikë shqetësuese mungesa e qendrave pritëse për të miturin viktimë në Qarkun e Dibrës.

4.5.3 ZBATIMI I DETYRIMEVE DHE PARIMEVE QË RRJEDHIN NGA KDPM

Me udhëzimin nr.06 datë 18.06.2018 është udhëzuar krijimi i regjistrit të posaçëm të masës alternative të shmangies nga ndjekja penale “*Paralajmërim me gojë*” në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë si dhe nenit 66 pika 2 të KDPM;

Gjithashtu gjatë hetimit dhe në përfundim të tyre janë zbatuar: Urdhri nr.4951 datë 02.05.2018 “*Për miratimin e formatit dhe të dhënave për masën alternative të shmangies nga ndjekja penale “Paralajmërim me shkrim”*” dhe urdhri nr.7641 datë 05.07.2018 “*Për përcaktimin e elementëve të marrëveshjes për zbatimin e masës së shmangies dhe/ose ndërmjetësimin*” të Ministrit të Drejtësisë;

Në zbatim të VKM –së nr.635 datë 26.10.2018 është njoftuar Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës kur ka rezultuar se i mituri nuk kishte mbushur moshën për përgjegjësi penale.

Gjatë trajtimit të çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin, të mitur viktimë apo të mitur dëshmitar në çdo rast i është dhënë përparësi interesit më të lartë të fëmijës duke mbajtur në konsideratë nevojat e fëmijës, mendimin e tij, historikun, nevojat e familjes dhe vazhdimësia e marrëdhënieve brenda familjes.

Nisur nga sa më sipër, referuar edhe të dhënave statistikore, rezulton se nga ana jonë i është dhënë përparësi masave alternative të shmangies. Kështu nga 28 të mitur në konflikt me ligjin, për 14 prej tyre është proceduar me pushimin e çështjes në bazë të nenit 55, 56, 58 dhe 67 të ligjit nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të miturit”, si edhe nenit 328 germa “f”, të Kodit të Procedurës Penale, për shkak se ndaj të miturit në konflikt me ligjin, është zbatuar masa e shmangies nga ndjekja penale.

Në një rast është kërkuar pushimi i çështjes në gjykatë dhe vetëm për 5 çështje me 7 të pandehur të mitur në konflikt me ligjin është kërkuar dërgimi i çështjes për gjykim. Ndërsa 6 çështjet e tjera për të cilat është kërkuar dërgimi i çështjes për gjykim, rezulton se i mituri ka qenë viktimë e veprës penale.

Vlen të theksohet se nuk ka pasur raste të recidivizmit nga ana e të miturve në konflikt me ligjin për të cilët është aplikuar masa alternative e shmangies nga ndjekja penale.

Në çdo rast kur rezulton se pjesë e një procesi penal është një i mitur nga ana jonë janë marrë masa që i mituri të asistohet nga një mbrojtës i caktuar ose i zgjedhur (nëse ka), nga një psikolog, nga përfaqësuesi ligjor dhe/ose personi i besuar.

4.5.4 NË PRIORITETET PËR PERIUdhËN NË VAZHDIM:

Së pari, zgjerimi i rasteve të aplikimit të masave alternative të shmangies nga ndjekja penale si në numër ashtu edhe në llojshmëri. Deri më tani nga ana jonë është aplikuar si masë alternative vetëm “Paralajmërimi me shkrim” dhe nuk ka pasur raste të aplikimit të masave të tjera të parashikuara nga Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur. Kjo situatë vjen jo vetëm për shkak të mungesës së institucioneve por edhe për shkak të ngarkesës së prokurorëve. Aktualisht në Prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër ushtrojnë funksionin efektivisht vetëm tre prokurorë, ku secili prokuror përgjatë vitit 2018 ka verifikuar dhe hetuar një mesatare prej rreth 370 materialesh.

Së dyti, marrja e masave që garantojnë rishoqërimin, riintegrimin dhe rehabilitimin e të miturve në kontakt ose konflikt me ligjin me qëllim parandalim të ripërfshirjes në krime të të miturve.

Së dyti, marrja e masave për të garantimin e procesit të rregullt ligjor për të miturit si dhe garantimin e aksesueshmërisë të të drejtave që legjislacioni në fuqi garanton për të miturit në konflikt me ligjin, të miturit viktimë apo dëshmitar.

4.6 TË DHËNA PËR PASOJAT E VEPRAVE PENALE:

Sa i përket të dhënave lidhur me pasojat e veprave penale, sipas statistikave rezultojnë se për vitin 2018, ka pasur vetëm 6 raste të plagosjes së rëndë dhe 14 raste të plagosjes së lehtë në dëm të shëndetit të personit. Janë regjistruar 4 vrasje me dashje ku vetëm në një rast vrasja ka mbetur në tentativë. Janë regjistruar 4 procedime penale për nenin 78 të Kodit Penal ku në tre raste vepra penale ka mbetur në tentativë si dhe në një rast është regjistruar çështje penale për nenin 79/dh të Kodit Penal ku vepra penale ka mbetur në tentativë. Janë regjistruar 4 raste vdekje të 4 punëtorëve gjatë punës në minierat e Bulqizës.

Gjithashtu, pasojat në dëme materiale apo jo materiale kanë ardhur më shumë në sektorin privat, por edhe në atë shtetëror.

KREU V

TË DHËNA LIDHUR ME MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA

1.1 Ekstradime (ekstradime nga jashtë, ekstradime për jashtë);

Nga të dhënat e verifikuara, rezultojnë së gjate vitit 2018, është kërkuar ekstradim për jashtë shtetit ndaj 4 personave, kërkesë e cila është refuzuar nga gjykata në një rast dhe është pranuar në 3 raste të tjera.

1.2 Letër porositë, (letërporositë nga jashtë, komisione rogatore dhe dorrëzime të kontrolluara, letërporositë për jashtë);

Janë ekzekutuar 23 letër-porosi nga jashtë shtetit, në përgjithësi për njoftim të akteve personave të dënuar etj.

1.3 Njohjet e vendimeve penale (njohjet e vendimeve penale të huaja, njohja e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit);

Në një rast është kërkuar njohja e vendimit penal të huaj nga ana e autoriteteve kosovare të drejtësisë, kërkesë e cila është rrëzuar nga ana e gjykatës për shkak të kalimit të afatit për të cilin i dënuari ishte vendosur nën mbikëqyrje nga zyra e shërbimit të provës.

1.4 Transferimi i procedimeve penale (transferimi i procedimeve nga jashtë, transferimet e procedimeve për jashtë);

Në dy raste Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Dibrë ka trajtuar materiale kallëzuese të ardhura me transferim nga autoritetet e huaja. Në një rast autoritetet slovene të drejtësisë kanë përcjellë procedimin penal të regjistruar për veprën penale të “*Falsifikimit letërnjoftimeve, pasaportave apo vizave*”, parashikuar nga neni 189 i Kodit Penal, procedim i regjistruar në

ngarkim të një shtetasi shqiptar. Në rastin tjetër autoritetet malazeze të drejtësisë kanë përcjellë procedimin penal të regjistruar për veprën penale të “Vjedhjes”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal, procedim i regjistruar në ngarkim të një shtetasi shqiptar. Në të dy rastet nga ana jonë është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal përkatës dhe kanë vazhduar hetimet.

KREU VI

6.1 Të dhëna për ngarkesën e punës për çdo prokuror dhe oficer të policisë gjyqësore:

Në organikën e Prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër janë parashikuar të jenë 6 prokurorë, përfshirë drejtuesin e prokurorisë. Aktualisht, ushtrojnë detyrën në këtë prokurori, vetëm 3 prokurorë **Rifat Kojku, Belina Kryemadhi (Zeneli) dhe drejtuesja Esmeralda Cami.**

Prokurori **Shkëlzen Cena**, emërimi i të cilit është në Prokurorinë Dibër, në prill të vitit 2018 është caktuar përkohësisht në Prokuroritë e Tiranës. Prokurori **Urim Buci**, emërimi i të cilit është në Prokurorinë Dibër, në nëntor të vitit 2018 është caktuar përkohësisht në Prokuroritë e Kurbinut. Ndërsa prokuror **Tom Dedaj** gjithashtu me emërim në Prokurorinë Dibër, është pezulluar në nëntor të vitit 2016 dhe aktualisht i shkarkuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Gjithashtu seksioni i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër parashikon në organikë dy oficerë, ku aktualisht ushtrojnë detyrën në këto pozicione OPGJ Aldo Puca dhe OPGJ Erisa Skara.

Kjo ngarkesë punë paraqitet si më poshtë:

1. Prokurori Rifat Kojku (periudha 01.01.2018-31.12.2018):

- Ka hetuar gjithsej **318 procedime penale**, nga të cilat:
 - **121** çështje janë dërguar për gjykim (*Kërkesë për dërgimin e çështjes për gjykim, Kërkesë për miratim marrëveshje apo Urdhër Penal*);
 - **40** çështje janë pezulluar;
 - **59** çështje janë pushuar ose është kërkuar pushimi në gjykatë;
 - **3** çështje janë dërguar për kompetencë;
 - **95** çështje janë mbartur për në vitin 2019;

- ka trajtuar **78 materiale kallëzuese**, nga të cilat
 - **72** kallëzime penale janë mosfilluar;
 - **6** kallëzime penale janë mbartur për në vitin 2019.

2. Prokurori Shkëlzen Cena (periudha 01.01.2018-12.04.2018):

- Ka hetuar gjithsej **22 procedime penale**, nga të cilat:
 - **13** çështje janë dërguar për gjykim (*Kërkesë për dërgimin e çështjes për gjykim, Kërkesë për miratim marrëveshje apo Urdhër Penal*);
 - **3** çështje janë pezulluar;
 - **6** çështje janë pushuar ose është kërkuar pushimi në gjykatë;

 - ka trajtuar **11 materiale kallëzuese**, të cilat janë mosfilluar;

3. Prokurore Belina Krvemadhi (Zeneli) (periudha 01.01.2018-31.12.2018):

- Ka hetuar gjithsej **124 procedime penale**, nga të cilat:
 - **21** çështje janë dërguar për gjykim (*Kërkesë për dërgimin e çështjes për gjykim, Kërkesë për miratim marrëveshje apo Urdhër Penal*);
 - **1** çështje është pezulluar;
 - **4** çështje janë pushuar ose është kërkuar pushimi në gjykatë;
 - **98** çështje janë mbartur për në vitin 2019;

- ka trajtuar **200 materiale kallëzuese**, nga të cilat:
 - **9** kallëzime penale janë mosfilluar;
 - **191** kallëzime penale janë mbartur për në vitin 2019

- Ka urdhëruar ekzekutimin për **24 Vendime Penale të formës së prerë**.

4. Prokurori Urim Buci (periudha 01.01.2018-02.11.2018):

- Ka hetuar gjithsej **73 procedime penale**, nga të cilat:
 - **45** çështje janë dërguar për gjykim (*Kërkesë për dërgimin e çështjes për gjykim, Kërkesë për miratim marrëveshje apo Urdhër Penal*);
 - **7** çështje janë pezulluar;
 - **19** çështje janë pushuar ose është kërkuar pushimi në gjykatë;
 - **2** çështje janë dërguar për kopetencë;

 - Ka trajtuar **63 materjale kallëzuese**, nga të cilat **janë mosfilluar**;

5. Drejtuuesi i Prokurorisë Esmeralda Cami, (periudha 01.01.2018-31.12.2018):

- Ka hetuar gjithsej **321 procedime penale**, nga të cilat:
 - **150** çështje janë dërguar për gjykim (*Kërkesë për dërgimin e çështjes për gjykim, Kërkesë për miratim marrëveshje apo Urdhër Penal*);
 - **52** çështje janë pezulluar;
 - **45** çështje janë pushuar ose është kërkuar pushimi në gjykatë;
 - **10** çështje janë dërguar për kompetencë;
 - **64** çështje janë mbartur për në vitin 2019;

- Ka trajtuar **75 materiale kallëzuese**, nga të cilat:
 - **60** kallëzime penale janë mosfilluar;
 - **15** kallëzime penale janë mbartur për në vitin 2019.

- Ka urdhëruar ekzekutimin për **330 Vendime penale të formës së prerë**;

- Dhe në përmbushje të detyrës së drejtuesit janë nxjerrë urdhra, udhëzime, kërkesa për informacion etj, të pasqyruara në mënyrë të hollësishme në pikën 6.2, të këtij Kreu;

Oficeri i policisë gjyqësore **Aldo Puca**, ka hetuar **111 procedime penale**. Për 75 prej tyre ka përfunduar hetimet. Ka sugjeruar dërgimin për gjykim të 59 procedimeve, për pushim 15 procedime, për pezullim 1 procedime, dhe për kompetencë 0 procedime. Ka sugjeruar mosfillimin për **20 materiale kallëzuese**. Ka mbartur për hetim 36 procedime penale. Ka ekzekutuar **12 letër-porosi** të kërkuara nga autoritetet e huaja, dhe ka kryer **42 veprime hetimore të deleguara** posaçërisht nga prokurorët.

Oficeri i policisë gjyqësore **Erisa Skara**, ka hetuar 79 procedime penale. Për 55 prej tyre ka përfunduar hetimet. Ka sugjeruar dërgimin për gjykim të 32 procedimeve, për pushim 17 procedime, për pezullim 4 procedime, dhe për kompetencë 2 procedim penal. Ka sugjeruar mosfillimin për 7 materiale kallëzuese. Ka mbartur për hetim 24 procedime penale.

Me ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale, hyrë në fuqi më datë 01.08.2017, nga ana e prokurorëve janë implementuar procedurat e reja lidhur më zgjidhjen ligjore të procedimeve penale, si kërkesat për dërgimin e çështjes në gjyq, marrëveshjet e fajësisë, urdhrat penal, kërkesat për pushimin e çështjeve për krimet, pushimet e çështjeve për kundërvajtjet penale etj.

Prokuror	PROCEDIME PENALE										KALLZIME		Totali për vitin 2018 (procedime + kallëzime)
	Kërkesë Dërgimi Gjyqit	Marrëveshje	Urdhër Penal	Pezullim	Kompetencë	Pushim	Kërkesë Për pushim	Kërkesë Për pushim parashkrim	Procedime në hetim (Mbartur)	Totali i procedimeve	Mosfillime	Kallëzime për verifikim	
Sh. Cena	8	0	5	3	0	1	5	0	0	22	11	0	33
B. Kryemadhi	16	5	0	1	0	1	3	0	98	124	9	191	324
U. Buci	21	4	20	7	2	8	10	1	0	73	63	0	136
R. Kojku	90	1	30	40	3	28	28	3	95	318	72	6	396
E. Cami	71	6	73	52	10	16	29	0	64	321	60	15	396

6.2 Ushtrimi i rolit dhe kompetencave të Drejtuesit të Prokurorisë:

Gjatë periudhës që analizojmë nga Drejtuesi i Prokurorisë është ushtruar studimi i të gjitha materialeve kallëzuese dhe të referuara nga Policia Gjyqësore e ato me vendngjarje, duke marrë masa për shpërndarjen e tyre në bazë të shortit, ngarkesës dhe gatishmërinë. Në të gjitha rastet është bërë përpjekje për një respektim të një proporcionalitetit në shpërndarjen e ngarkesës për prokuror dhe oficer të policisë gjyqësore, kjo e evidentuar dhe në statistikën e lartpërmendur.

Urdhrat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm, janë punuar dhe diskutuar për implementimin e tyre.

Gjithashtu në përmbushje të detyrave janë marrë masa për organizimin e punës dhe mirëfunksionimin e prokurorisë. Në këtë kuadër janë nxjerrë disa urdhra dhe udhëzime, të cilat po i citojmë si më poshtë:

1. Udhëzim nr.01/1 “Për zbatimin e ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe Krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar”;
2. Udhëzim nr.01/2 “Për pajisjen me certifikatë sigurie dhe administrimi informacionit të klasifikuar sekret shtetëror”;
3. Urdhër nr.01 “Për mënyrën e funksionimit të zyrës së ekzekutimeve të vendimeve penale dhe kontrollin e zbatimit të tyre” ;
4. Urdhër nr.38 datë 05.11.2018 “Për dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të fashikujve të procedimeve dhe të materialeve kallëzuese”;
5. Urdhër nr.28 datë 01.10.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e komisionit disiplinor për punonjësit e policisë gjyqësore”;
6. Urdhër nr.24 datë 04.09.2018 “Për shpërndarjen me short të çështjeve të mbërritura në Prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër nga data 01.08.2018 deri më datë 31.08.2018, për të cilat nuk ka qenë e nevojshme kryerja e veprimeve të menjëhershme si dhe procedurën që do të ndiqet në vazhdimësi”;
7. Udhëzim nr.8 datë 02.07.2018, “Për evidentimin e gjendjes së aktivëve dhe gjendjes financiare të Prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër”;
8. Udhëzim nr.20 datë 09.07.2018, “Për shlyerjen e detyrimeve ndaj ekspertëve, psikologëve, mbrojtësve etj.”;
9. Urdhër nr.21 datë 23.07.2018, “Për Funksionimin Administrativ të Prokurorisë për Periudhën e Lejeve të Zakonshme miratimin e lejes vjetore për prokurorët dhe punonjësit e administratës dhe delegimin e kompetencave”;
10. Udhëzim nr.6 datë 18.06.2018 “Për krijimin e regjistrit të posaçëm të masës alternative të shmangies nga ndjekja penale “Paralajmërim me gojë”;

Procedura e ndjekur për zbatimin e kompetencave në ushtrimin e ndjekjes penale;

Nga ana e drejtuesit të prokurorisë është respektuar pavarësia e prokurorëve duke zbatuar kompetencat, për aq sa janë të parashikuara në ligjin nr.97/2016 “*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*” siç janë:

Kërkesat për informacion (si fillesë për nxjerrjen e udhëzimeve me shkrim):

Në zbatim të nenit 43 dhe 48 të ligjit nr.97/2016 “*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*” nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është aplikuar kërkesa për informacion për çështje konkrete si dhe dhënia e Udhëzimeve jo të detyrueshme.

Informacioni i përgatitur nga prokurorët do të shërbente për verifikimin e ecurisë dhe përfundimin e çështjes dhe dhënien e “*Udhëzimeve jo të detyrueshme*” në bazë të nenit 43 germa “b”, “ç” dhe nenit 48 të ligjit nr.97/2016 “*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*”

Udhëzime me shkrim, jo të detyrueshme

Më datë 17.12.2018 është nxjerrë Udhëzimi jo i detyrueshëm për Procedimin penal nr.347 të vitit 2017, ku është udhëzuar kryerja e disa veprimeve procedurale me qëllim përfundimin e çështjes.

Akt “Për verifikimin e ecurisë dhe përfundimin e procedimit penal”

Për tetë procedime penale është hartuar akti për verifikimin e ecurisë dhe përfundimin e procedimit penal, në bazë të nenit 43 germa “ç”, të ligjit nr.97/2017 “*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*” dhe pas kërkesës për informacion.

KREU VII

INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN E PROKURORISË

Në mbarëvajtjen e punës të veprimtarisë së Prokurorisë, një rol të rëndësishëm kryen dhe administrata e Prokurorisë.

Rezulton tashme një evidencë e sakte dhe e qartë që nga momenti i protokollimit të materialeve në k/sekretari, e më pas në regjistrat e kallëzimeve, procedimeve penale, të mosfillimeve, të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë etj, mbajtur nga zyra e regjistratit.

Të gjitha kallëzimet dhe procedimet janë regjistruar ne sistemin CAMS duke operuar me kujdes në këtë sistem për të pasqyruar saktë të dhënat përkatëse ne bashkëpunim dhe më strukturën përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme.

Nga ana e Zyrës së financës janë evidentuar me korrektësi shpenzimet procedurale të çështjeve penale të parapaguara nga shteti e të mbajtur nga prokurorët. Gjithashtu nga kjo Zyrë është mbajtur evidence e saktë në lidhje me pagesat e gatishmërisë dhe orëve jashtë orarit zyrtar, që rezultojnë në vlerën 1 461 mijë lekë. Janë shlyer detyrimet për mbrojtësit e caktuar ne shumën 544 mije leke, për ekspertë në shumën 850 mijë lekë gjithsej, për ekspertimet piroteknike ne shumën 725 mije lekë, dhe për ekspertimet mjeko-ligjore në shumën 526 mijë lekë, etj. Në kuadër të zbatimit të V.K.M Nr.591, datë 23.07.2010 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore” nga ana jonë po bëhen përpjekje për një menaxhim sa më të kujdesshëm të këtyre fondeve.

I është kushtuar kujdes ruajtjes dhe sigurisë së objektit të prokurorisë duke realizuar me sukses prokurimet me shërbim roje privatë, me mbikëqyrjen e shërbimit të tyre etj.

Një kujdes i veçantë i është kushtuar respektimit të disiplinës në punë dhe etikës nga punonjësit e prokurorisë. Është ushtruar kontrolli i brendshëm për zbatimin e tyre dhe në raste të caktuara janë marrë masa për organizimin e mbledhjeve me objekt diskutimin dhe tërheqjen e vëmendjes në lidhje me problematikat e konstatuara. Kodi i Etikës, parashikon standarte të qarta dhe të detyrueshme sjelljeje për prokurorët, në thelb të të cilave qëndron detyrimi që ata të veprojnë në përputhje me të drejtat e njeriut dhe efektivitetin e drejtësisë penale.

Për shkelje të ligjit dhe të etikës për një prokuror, Prokurori i Përgjithshëm ka marrë masën e pezullimit nga detyra, deri në përfundim të hetimeve.

KREU VIII

DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN PASARDHËS DHE REKOMANDIME

Sa u referuan treguesit e sipërpërmendur, në analizë të tyre, duhet të evidentojmë dhe drejtimit kryesore të punës dhe veprimtarisë për vitin në vazhdim, duke përcaktuar dhe prioritetet kryesore.

8.1 Nga drejtimit duhen vlerësuar :

Së pari, një ndër drejtimit kryesore të veprimtarisë së punës për vitin 2018, është ngritja e cilësisë së hetimeve, pra e cilësisë së veprimeve hetimore të procedimeve penale. Cilësia në veprime pasqyron së pari ngritjen profesionale të çdo Prokurori dhe Oficeri të Policisë

Gjyqësore, duke e pasqyruar atë në përpilimin e akteve, formulimit dhe arsytimit ligjor të vendimeve gjatë hetimit, ato përfundimtare si dhe përfaqësimit në Gjykatë.

Së dyti, duhet rritur ndjeshëm kontrolli në dinamikë nga ana e Prokurorëve gjatë hetimeve paraprake të çështjeve, duke mos u mjaftuar vetëm me nxjerrjen e një urdhri për kryerje veprimesh hetimore, pritjen deri në ardhjen e akteve nga shërbimet dhe seksionet e Policisë Gjyqësore, duke shkaktuar vonesa në hetim, humbjen e aktualitetit të një veprimi hetimor që mund të rezultojë gjatë dinamikës etj. Në dinamikë gjatë kontrollit të veprimtarisë hetimore nga oficeri i Policisë Gjyqësore, Prokurori duhet të jete jo vetëm një orientues i veprimeve hetimore apo të nxjerrë akte procedurale për veprime specifike si kontrolle përgjime etj, por duhet të jetë edhe iniciues apo nxitës për një hetim sa më dinamik, të shpejtë, të një hetimi të zgjeruar për të gjitha problematikat. Duhet të evidentojë konkretisht dhe përcjellë me informacione Drejtuesit të Prokurorisë problematika të veçanta, pengesa të ndryshme qoftë që kanë të bëjnë dhe me mënyrën e funksionimit të organizimit të punës së veprimtarisë hetimore, siç janë zvarritjet e pajustificueshme etj.

Së treti, për çështje të veçanta për shkak të rrezikshmërisë shoqërore apo përhapjes së një krimi duke ju referuar tendencës pra të kriminalitetit, aq më tepër për çështje të renda dhe sensitive duhet bërë vlerësimi i diferencuar, kryer analiza të vlerësimit të hetimeve dhe provave të administruara, duke lënë detyra konkrete, si dhe duke kryer vetë nga Prokurorët veprime hetimore.

8.2 Në prioritet për vitin 2019:

Evidentimi, vlerësimi dhe hetimi i veprave penale të referuara apo të evidentuara kryesisht, që lidhen me veprime korruptive, të cilat kanë të bëjnë me subjekte të administratës shtetërore apo private. Duhet nënvizuar fakti që nga ana e Prokurorëve duhet treguar vëmendje më e madhe në drejtim të vlerësimit të fakteve që rezultojnë gjatë hetimeve, për raste kur konstatohen indicje për vepra penale të karakterit korruptiv. Duhet treguar vëmendje dhe në drejtim të fakteve për të cilat ndjehet shqetësim i përgjithshëm i komunitetit;

Kryerja e analizave të përbashkëta me seksionet dhe sektorët e shërbimeve të policisë për veprat penale sensitive, por edhe me faktorë të tjerë, ku duhet përmendur veprat penale kundër pasurisë, kundër autoritetit të shtetit dhe korrupsionit, duke rritur rastet e hetimeve proaktive dhe veprimeve simuluese. Kryerja e trajnimeve të vazhdueshme për implementimin dhe zbatimin e procedurave ligjore të ndryshuara në hetimin e çështjeve etj;

Hetime sistematike pasurore dhe rritje të numrit të aseteve të konfiskuara, në zbatim të ligjit 10192/2009, ndryshuar me ligjin 70/2017, specifikisht në drejtim të masave parandaluese;

Ndjekjen e një politike penale të përshtatshme ndaj të miturve, grave dhe personave me aftësi të kufizuara që procedohen penalisht si në aplikimin e masave të sigurimit edhe në aplikimin e dënimeve alternative;

Marrjen e masave për ushtrimin e ndjekjes penale në bazë të ligjit për çdo referim/kallëzim i cili përmban element të figurës së veprës penale. Disponimi me vendim për mosfillimin si procedim penal, brenda afatit prej 15 ditësh, për kallëzimet/referimet për të cilat ekzistojnë shkaqe dhe rrethana që nuk lejojnë fillimin e një procedimi penal.

Rritjen e përpjekje për të bërë të mundur rritjen e treguesve të zbulueshmërisë së veprave penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore, si vrasjet, vjedhjet etj. Përfaqësimi me sukses për akuzën për fazën e gjyqimit të çështjeve që lidhen me ngjarje të rënda kriminale.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

DREJTUESI I PROKURORISË

ESMERALDA CAMI